

5

Kapaciteti për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta

5.1 Kapaciteti kombëtar

5.1.1 Ministria e Mbrojtjes

MINISTRIA SHQIPTARE E MBROJTJES ka një sërë përgjegjësish në lidhje me kontrollet e armëve të vogla dhe të lehta. Ky seksion fokusohet në katër fusha në të cilat Ministria e Mbrojtjes konsiderohet të luajë rol kryesor:

- Prodhimi
- Menaxhimi i tepricave të municioneve dhe armëve të vogla dhe të lehta
- Kapaciteti për shkatërrimin e municionit dhe armëve të vogla dhe të lehta
- Sistemi i kontrollit të importit dhe eksportit

5.1.1.1 Prodhimi

Që prej vitit 1962 Shqipëria ka prodhuar municione, eksplozivë dhe armë të vogla e të lehta të ndryshme (psh, AK-47 kineze të modifikuara) në uzinat e prodhimit ushtarak të Gramshit, Mjekesit dhe Poliçanit.³⁴³ Uzina e Grmashit filloi të prodhojë një model kinez të pushkës së tipit ‘Smirnov’ të kalibrit 7.62 mm me licence në vitin 1966 dhe modele AK-47 në 1974. Mjekesi përbëhet nga gjashtë uzina me vendodhje në qytetin e Elbasanit, të cilat prodhojnë eksplozivë me licence nga Bofors që prej vitit 1982. Poliçani i specializuar në prodhimin e municioneve, prodhon municione të kalibrit 7.62 x 39 mm, shtimje mortaje 82 mm, granada dhe mina antipersonel dhe midis viteve 1970–2 filluan të prezantohen minat antitank dhe shtimjet 180 mm. Në periudhën midis viteve 1977–1985 nga Zvicra dhe Austria erdhën makineri të reja që mundësonin prodhimin e municionit të kalibrit 12.7 x 99 mm dhe 14.5 x 51 mm dhe shtimjeve të mortajave 60 mm, 107 mm dhe 120 mm. Për më tepër, Poliçani ishte pajisur për të prodhuar municion 19 mm për pistoletat e tipit Makarov dhe Parabellum. Është debatuar se uzinat shqiptare të prodhimit ushtarak kishin kapacitet të konsiderueshëm prodhues të armëve të vogla dhe të lehta. Për shëmbull, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes deklaruan se Gramshi kishte kapacitet për të prodhuar 26,000 pushkë automatike në vit duke përdorur katër ose pesë modele të ndryshme.³⁴⁴

Megjithatë, nga mesi i viteve 90, shumë nga pajisjet e prodhimit u prishën, ishin

³⁴³ Ky seksion bazohet në informacionin e marrë nga faqja e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë, <<http://www.MOD.gov.al/eng/industria/ndermarjet.asp>>, 12 qershor 2005.

³⁴⁴ Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 18 korrik 2005.

grabitur ose kishin dalë jashtë përdorimit për sa i përket prodhimit të armëve të vogla dhe të lehta që të mund të konkurronin në tregun³⁴⁵ ndërkombëtar të armëve. Për shëmbull, sipas një artikulli gazete të marsit të vitit 2005, uzina e prodhimit ushtarak në Poliçan, që kish të ngjarë të punësonte 4,000 njerëz për prodhimin e municionit dhe armëve të vogla dhe të lehta gjatë kulmit të saj në fund të viteve 60 dhe në fillim të viteve 70, u braktis në masë në vitin 1999.³⁴⁶ Sipas drejtorit të uzinës, në vitin 1990 u punësuan 3,200 punëtorë, por në 1994, u punësuan vetëm më shumë se gjysma e këtij numri (1,700).³⁴⁷ Nga viti 2004, ky numër kishte rënë në 900 dhe sot sipas raporteve ka vetëm 264 punonjës duke përfshirë sektorin e menaxhimit. Ata që ishin në gjëndje të dilnin në pension të parakohshëm, tashmë gëzojnë një pension mujor prej 10,000 lekësh (rreth €80). Sipas raporteve 140 njerëz të angazhuar në kryerjen e punimeve xhenio dhe projekteve të çmilitarizimit mbi pajisjet ushtarake të tepërta – kryesisht shtimje 85 mm dhe 100 mm.³⁴⁸ Më tepër se prodhimin e AVL dhe municionit për shitje në tregun ndërkombëtar të armëve, këto uzina ndihmojnë në ngritjen e fondeve për të forcuar buxhetin për modernizimin e Ministrisë së Mbrojtjes duke transformuar AVL dhe municionet në produkte për shitje në tregun ndërkombëtar të hekurishteve të skrapit. Duhet vërejtur se uzina e Mjekesit bën prodhimin në shkallë të vogël të eksplozivëve komercialë.³⁴⁹

Sipas një raporti të dorëzuar UNDDA (Departamentit të Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Çmilitarizimit) in 2004, Shqipëria nuk ka një ligj për prodhimin e AVL sepse nuk ka një politikë aktuale për prodhimin e AVL në Shqipëri ose fabrikim të tyre.³⁵⁰ Raporti deklaroi se AVL nuk janë fabrikuar në uzinat ushtarake shqiptare që prej vitit 1990 dhe kreu aktual i kompanisë ushtarake të import-eksportit MEICO informoi autorin se Shqipëria nuk ka prodhuar municion gjatë këtyre pesë viteve të fundit.³⁵¹ Ai deklaroi se ka patur kërkesa nga kompani amerikane që municione dhe armë trofe e ndoshta dhe pushkë të prodhohen në Gramsh. Këto kërkesa përfshinin oferta për intalimin e pajisjeve dhe sigurimin e lëndës së parë për të rifilluar prodhimin. Megjithatë, ai dyshoi nëse ka personel të trajnuar të aftë për të përmbytur këto udhra dhe nëse ato do të jenë fitimprurëse. Sipas tij, do nevojitej investim kapitali të konsiderueshëm për këto uzina që të konkurronin në tregun ndërkombëtar.³⁵² Ai beson gjithashtu se nuk ka fare të ngjarë që do ketë një uzinë ushtarake shtetërore në shkallë të gjerë në Shqipëri në një të ardhme të afërt.

Megjithatë, që prej vitit 1990 në uzinat e prodhimit ushtarak është bërë prodhimi dhe riparimi i armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve.³⁵³ Bazat e të dhënave në faqen e Internetit të NISAT tregojnë se Shqipëria prodhonte pushkë dhe karabina në Gramsh në vitin 2001,³⁵⁴ dhe një numër të intervistuarish deklaruan se kishte raste të kufizuara dhe të rralla të prodhimit të municioneve në uzinën e Poliçanit për eksport në Turqi dhe SHBA.³⁵⁵ Për shëmbull, drejtori i Uzinës Ushtarake të Poliçanit, Memli Kasapi, informoi ekipin studimor që ata vazhdojnë të prodhojnë pajisje 7.62 mm për përdorim ushtarak, shtimje 9 mm për Ministrinë e Brendshme dhe shtimje 85 mm për përdorim ceremonial.³⁵⁶

Duket se Turqia po tregon interes të veçantë për shikimin e mundësive në lidhje me prodhimin e municionit me licensë në Shqipëri. Për shëmbull, gjatë 40 vjetorit të

345 Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 Prill 2005.

346 'Ministri shqiptar i Mbrojtjes premtion gjallërimin e fabrikës së prodhimit të armëve', BBC Monitoring Service. Burimi: Koha Jone, 22 mars 2005.

347 Intervista, Zyrtari i Ministrisë së Mbrojtjes, 29 korrik 2005.

348 Ibid; intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

349 Ibid.

350 Albania UN PoA Report 2004. Ky raport rithekson deklaratat e bëra një vit më parë në një letër të datës 8 korrik 2003 nga Misioni i përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Kombet e Bashkuara drejtuar Departamentit të Çështjeve të Carmatimit mbi Programin e Veprimt, A/CONF.192/BMS/2003/CRP.93 (Albania UN Letter 2003').

351 Intervista, Zyrtari i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.

352 Ky opinion është ndarë gjithashtu në intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

353 Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 21 prill 2005.

354 Burimi: NISAT databases website <www.nisat.org>.

355 Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 29 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 29 prill 2005. Kjo u konfirmua nga zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 18 korrik 2005.

356 Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 29 korrik 2005.

përkujtimit të ndërtesës në mars 2005, Ministri i atëhershëm i Mbrojtjes, Pandeli Majko deklaroi se qeveritë shqiptare dhe turke po punojnë drejt hapjes së një linje të re prodhimi në uzinë³⁵⁷ për prodhimin në Poliçan. Gjithashtu, të pranishëm në ceremoni ishin atashu ushtarak i Turqisë, Kolonel Ali Ozgun dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Pellumb Qazimi. Në intervistat e kryera në korrik të vitit 2005 u konfirmua se makineria e re e sjellë në Poliçan nga Turqia, si linja e vetme e prodhimit po funksiononte në një tunel të nëndheshëm në Poliçan.³⁵⁸ Nuk ishte e qartë nëse Poliçani do të operojë me licensë, megjithëse kjo duket të jetë e mundur, pasi zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes kanë konfirmuar se municioni do të prodhohet ekskluzivisht për ushtarakët turq.³⁵⁹ Nëse ndodh kështu, atëherë do të ishte e përshtatshme për qeverinë shqiptare të konsideronte punën mbi hartimin e legjislacionit të përshtatshëm për prodhimin ushtarak në Shqipëri, si dhe për transfertën e armëve dhe materialeve të ngjashme të prodhuara sipas marrëveshjeve të prodhimit të licensuar, duke i kushtuar vëmendje të vecantë shmangies së zonave gri në lidhje me prodhimin e materialeve ushtarake me licensë në Shqipëri.

5.1.1.2. Menaxhimi i Rezervave

Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për menaxhimin e rezervave³⁶⁰ të armëve të vogla dhe të lehta dhe të municioneve. Ajo vendos për vendndodhjet e rezervave, bazuar në misionin dhe operacionet e detyrës dhe distancën e depozitave nga zonat e banuara dhe rrjeti kombëtar i rrugëve. Drejtoria e Projektimit të Mbrojtjes parashikohet të projektojë mjediset e magazinimit, duke marrë parasysh sigurinë e publikut dhe çështje të sigurisë. Rregullorja mbi armatimet dhe municionet e Ministrisë së Mbrojtjes përcakton qartë masat e sigurisë së depove, udhëzime mbi mbajtjen e të dhënave, detaje të përgjegjësive për inspektimet dhe procedurat që merren me vjedhjet, si dhe tentativat për vjedhje. Kjo është të paktën ajo çfarë duhet të ndodhë në lidhje me menaxhimin e armëve të vogla, armatimeve të lehta dhe municioneve të tepërta të Shqipërisë.

Ministria e Mbrojtjes ka marrë forma të ndryshme asistencë në këtë fushë, pasi ka kërkuar të arrijë anëtarësinë në NATO. Për shëmbull, në vitin 1999, firma, EOD Solutions me vendndodhje në Mbretërinë e Bashkuar hartoi një raport me synim përmirësimin e procedurave të menaxhimit të magazinimit të rezervave. Kjo u arrit për të siguruar që Ministria e Mbrojtjes të përmbushte normat e NATO-s. Raporti dha rekomandime sesi udhëzimet e NATO-s mbi magazinimin e municionit të mund të përshtateshin me sistemin ekzistues shqiptar gjatë tranzicionit për përafrimin³⁶¹ e plotë me NATO-n. Ndërmarrja import-eksporti e Ministrisë së Mbrojtjes, MEICO, ka asistuar gjithashtu në këtë proces me anë të hartimit të strategjisë së municioneve në vitin 2004. Strategjia jep detaje të objektivave, prioritetëve dhe fazave për magazinimin e rezervave dhe shkatërrimin e tyre.³⁶²

Si pjesë e angazhimeve të saj në procesin e NATO-s për Partneritetin për Paqe, Forcat e Armatosura Shqiptare kanë filluar një plan ristrukturimi që do të reduktojë ushtarakët shqiptarë në një fuqi të përgjithshme prej 35,000 vetash në personel, me vetëm 6,000 ushtarë profesionistë deri në vitin 2010.³⁶³ Ky proces do të ketë dhe një sërë impaktesh mbi nivelet e rezervave dhe menaxhimit e sigurisë së tyre. Më pak depo dhe personel aktiv do të nënkuptojnë më shumë materiale ushtarake të tepërta dhe më pak personel për kryerjen e detyrave të ruajtjes. Kjo do të ketë një impakt mjaft negativ në depot tashmë të mbingarkuara.

³⁵⁷ Op cit 'Ministri shqiptar i Mbrojtjes premtonte gjallërimin e fabrikës së prodhimit të armëve'.

³⁵⁸ Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 18 korrik 2005.

³⁵⁹ Ibid.

³⁶⁰ Burimi: Raport i PoA i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri 2004.

³⁶¹ Op cit Monitorimi i AVAL në Europën Juglindore 2005, fq. 30-1.

³⁶² Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 14 Prill 2005.

³⁶³ Intervista, parlamentar, 3 Maj 2005; Kusova, 19 shkurt 2003, fq. 64.

Megjithëse siguria, kushtet e magazinimit dhe mbajtja e të dhënave konsiderohen të jenë shumë më të mira se në vitin 1997, ende ka një sërë arsyesh për t'u preokupuar.

Kushtet e magazinimit

Numri i depove të armëve dhe municioneve në Shqipëri aktualisht po ulet, me stoqe që po centralizohen progresivisht për sa i përket vendndodhjes së tyre.³⁶⁴ Për shëmbull, në vitin 1998 Shqipëria kishte 167 depo që përmbanin 917 magazina për armë të vogla dhe armatime të lehta, municion dhe eksplozivë. Në vitin 2005, Shqipëria kishte 57 depo, me 474 magazina (195 prej të cilave janë tunele të nëndheshme). Numri përfundimtar i grupdepove pritet të jetë pesë ose gjashtë. Në vitin 2002, këto depo mbanin 151,039 njësi³⁶⁵ të tepricave të armëve të vogla dhe të lehta. Mbyllja e shpejtë e numrit të madh të depove kishte çuar në mbingarkimin e madh në depot³⁶⁶ që kishin mbetur. Për shëmbull, në depon e municioneve në Mirak, pikërisht jashtë Elbasanit, gjashtë magazina përmbajnë 3,600 tonë të llojeve të ndryshme të municionit, i cili është dyfishi i niveleve të vitit 1990.³⁶⁷ Për më tepër, depoja ka gjithashtu gjashtë tunele të nëndheshme, ku secili prej tyre përmban 2,000 tonë municion. Anëtarët e ekipit studimor hynë në dy prej magazinave dhe një prej tuneleve, ku arkat e drunjta të municioneve ishin bërë parg nga dyshemeja deri në tavan. Magazinat nuk kishin më hapësirë për një zyrë të menaxherit të magazinës, megjithëse ata me kohë shpresojnë të arrijnë një fazë ku vetëm tunelet e nëndheshme do të përdoren për magazinimin e municionit, duke siguruar kështu që asnjë municion të mos magazinohet sipër tokës në atë vendqëndrim. Mungesa e paletës ose edhe e hapësirës për kamionat të tipit vinç pirun, brënda magazinave do të thotë se të gjitha arkat që ndodhen brënda magazinave sipër tokës do të duhen të lëvizin me dorë. Ekipi studimor u informua se është praktikë e përhapur të mbushen plot blloqet e municionit deri në vendosjen e arkave në majë të pargjeve.³⁶⁸

Ndërsa arkat e drunjta që përdoren nuk i përmbushin standartet e NATO-s, disa vëzhgues shqiptarë dhe ndërkombëtarë janë të sigurt se rreziqet e shpërthimit nga përmbajtja janë të ulta. Ekipi studimor u informua se mostrat e stoqeve të Mirakut kontrollohen rregullisht për të identifikuar municionin që ka nivele të ulta stabilizuese dhe që duhet të konsiderohen një prioritet për shkatërrim.³⁶⁹ Megjithatë, shumë municione të vjetra që nuk kanë stabilizues janë transferuar gjatë vëndit, me reduktimin e depove. Ky fakt, që lidhet me municionin e pasistemuar që ishte dorëzuar nga civilët si dhe mbingarkimin e depove, i kishte bërë disa zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes Shqiptare të deklarorin se rreth gjysma e depove aktuale duhet të konsiderohen si “me rrezik të lartë” për detonim.³⁷⁰ Për të ndihmuar kontrollin e ndonjë shpërthimi në Mirak, kollonat fqinje të municionit nuk përmbajnë dy tipe identike të tyre.

Megjithatë, ndërtesat fqinje përbëjnë një arsye për t'u shqetësuar për sa i përket sigurisë publike. Një rrugë kryesore dhe një numër ndërtesash banimi ndodhen më pak se disa qindra metra nga magazinat në depot e municionit në Mirak, me depo të tjera, sipas raportimeve, edhe më afër zonave të banuara. Megjithëse shumë nga këto projekte ndërtimi për banim janë kryer pa leje zyrtare, autoritetet lokale janë, sipas raporteve, jo të gatshme të marrin masa nga frika se mos provokojnë reagime negative.³⁷¹ Megjithatë, nuk ndodh gjithmonë kështu: ekipi studimor u informua se

364 Burimi: Raport i PoA i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri 2004.

365 Sipas një urdhri qeveritar mbi nxjerrjen nga funksionimi SALË Decommission, e cila jep një listë gjithëpërfshirëse të njësisve të armëve të lehta dhe armatimeve të lehta të tepërta në magazinat shqiptare në vitin 2002. Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 14 Prill 2005.

366 Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

367 Magazinat ishin stalla në periudhën e ndërmjetme të luftës. Catia kishte rënë në një nga gjashtë deport e Mirakut, por fatmirësisht arkat me municione të sistemuara brënda mbanin tavanin. Të dhëna të mbledhura gjatë vizitës në depon e municionit në Mirak, 27 korrik 2005. Një i intervistuar deklaroi se disa depo përmbajnë trefishin e sasisë së municionit që ata ishin projektuar të mbanin. Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

368 Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

369 Të dhëna të mbledhura gjatë vizitës në depon e municionit në Mirak, 27 korrik 2005; intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

370 Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 14 prill 2005.

371 Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

një shkollë që ndodhej shumë afër depos së municionit në Mirak ishte mbyllur për shkak të problemeve të mundshme të sigurisë publike.

Në të njëjtën depo, i gjithë municioni ishte vendosur në kuti dhe nuk kishte asnjë njësi armësh të vogla e armatimesh të lehta të ruajtura në magazine. Një numër të intervistuarish ishin të sigurt se shumë depo që ishin përdorur për magazinimin e njërive të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta dhe municionit ishin siguruar në mjedise³⁷² më vete magazinimi. Megjithatë, ne u informuam se municioni i grumbulluar nga civilët arrin në depo, i përzier me materiale të tjera eksplozive, shpesh në të njëjtat shishe ose çanta plastike në të cilat ishte dorëzuar te grumbulluesit e armëve. Qendra Kombëtare e Çmilitarizimit (QKÇ) ka punuar sipas një kontrate për projekte, me synim ripaketimin e 900 tonëve të këtij municioni të pasistemuar për shkatërrim,³⁷³ por nevojitet të kryhet më shumë ripaketim. Një ish zyrtar i NAMSAs vlerësoi se mes totalit të rreth 150,000 tonëve municioni në stoqet e shtetit, ka 2,000 tonë municione të pasistemuara për shkatërrim.³⁷⁴

Siguria

Shumë depo mbështeten në tela me gjemba, drunj për dyer druri, dritare me shufra dhe pak dritë nga jashtë si masa kryesore sigurimi kundër vjedhjes. Nuk ka qenë të stërvitur, sisteme alarmi apo sisteme³⁷⁵ survejimi me video. Megjithatë, për shkak të reduktimit të vazhdueshëm në numrin e depove, ndoshta është e kuptueshme se masat e sigurisë së teknologjisë së lartë të kushtueshme nuk po përdoren në depot që janë projektuar të mbyllen në një të ardhme të afërt.³⁷⁶

Depot zakonisht ruhen nga ushtarë të keqpaguar të shërbimit të detyrueshëm, nga të cilët ka një numër³⁷⁷ të pamjaftueshëm, dhe në disa raste nga roja civile ose KRSE. Menaxheri i magazinës është përgjegjës të kontrollojë nëse magazinat janë mbyllur apo jo, që nuk ka shenja të hyrjes me forcë dhe se armët e vogla dhe të lehta dhe municionet nuk janë marrë.³⁷⁸ Një i intervistuar deklaroi se ai besonte se nuk mund të bëhej shumë për të ndaluar një shef magazine ose roje të rekrutuar nga tentativa për të asistuar në vjedhjet nga depot, në mënyrë aktive ose pasive.³⁷⁹ Megjithatë asnjë i intervistuar nuk deklaroi ndonjë besim në nivelet sistemike të korrupsionit dhe përvetësimit të armëve të vogla dhe të lehta e municionit nga depot, kjo nuk u hodh poshtë si mundësi. Depot që ndodhen në zonat kufitare u identifikuan si vëndi më i mundshëm për këtë lloj shpërdorimi të detyrës.

Një numër të intervistuarish deklaruan se nuk do të ishte e mundur që ushtarakët do të zbulonin raste para medias³⁸⁰ të vjedhjeve faktike ose të dyshuara të armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve. Megjithatë, ekipi studimor u informua se në vitin 2003, tre pistoleta – dy pistoleta sportive dhe një pistoletë TT e prodhuar në Kinë, ishin raportuar si të vjedhura nga depot e Ministrisë së Mbrojtjes.³⁸¹ Përgjigja më e përhapur ndaj pyetjeve në lidhje me rastet e njohura të personelit ushtarak të kapur duke u përpjekur të shesë armë të vogla dhe të lehta të vjedhura ose të lehtësojë aksesin në depo për të tjerët që të vjedhin armë të vogla dhe të lehta, ishte se konsiderohej më e lehtë dhe më e lirë thjesht të blije pjesë të armëve të vogla ose armatimeve të lehta e municioneve që ishin vjedhur në vitin 1997. Ishte vërejtur gjithashtu se si roja fizike e stoqeve, çdokush në zonë dhe në fabrika ose vendqendrimet nuk ka të ngjarë të rrezikojë ta fusi njëri tjetrin në telash nëpërmjet përfshirjes në aktet e vjedhjes.³⁸²

³⁷² Intervista, ish zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 18 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

³⁷³ Intervista, ish zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 18 prill 2005.

³⁷⁴ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

³⁷⁵ Burimi: Albania UN PoA Report 2004. Të dhëna të mbledhura gjatë vizitës në depon e municionit të Mirakut, 27 Korrik 2005.

³⁷⁶ Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 14 prill 2005.

³⁷⁷ Intervista, ish zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 18 prill 2005.

³⁷⁸ Ibid.

³⁷⁹ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 21 prill 2005

³⁸⁰ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005; Anon, gazetar investigativ, 21 Korrik 2005; zyrtar ndërkombëtar, 23 Korrik 2005.

³⁸¹ Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 14 prill 2005.

³⁸² Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

Megjithatë, në korrik 2005, u shfaq një artikull në gazetën *Shekulli* duke dhënë detaje sesi një ushtar i shërbimit të detyrueshëm, në disa raste³⁸³ kishte shitur municion, eksplozivë dhe materiale të tjera ushtarake nga njësia tankiste në “Arshi Lengo”. Fakti që ky ushtar i shërbimit të detyrueshëm dyshohej të kishte trafikuar pajisje ushtarake jashtë repartit në raste të mëparshme pa u kapur, sugjeron se masat e sigurisë kanë nevojë të rishikohen.

Mbajtja e të dhënave

Sipas raportit të Shqipërisë 2004 për Programin e Veprimit të Kombeve të Bashkuara mbi Armët e Vogla dhe të Lehta, të dhënat për mbajtjen, përdorimin, shpenzimet dhe asgjësimin mbahen për dhjetë vjet në nivel batalioni dhe në mënyrë të papërcaktuar në nivele brigade, divizioni dhe Shtabi të Përgjithshëm.³⁸⁴ Çdo vit kryhen ushtrime verifikimi në nivele batalioni, çdo dy vjet në nivel brigade dhe çdo katër vjet në nivel kombëtar nga ekspertë të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët kryejnë kontrolle fizike përkrah kontrolleve të librave të regjistrimit.³⁸⁵ Janë ngritur shqetësime tek ekipin studimor në lidhje me saktësinë e librave të regjistrimit të Ministrisë së Mbrojtjes mbi armët e vogla dhe të lehta dhe mbajtjet e municioneve, pasi numri i zyrtarëve në Tiranë me detyrë monitorimin e shkeljeve të Ministrisë së Mbrojtjes konsiderohet të jetë i vogël, kur krahasohet me sasinë e stoqeve që ata janë të ngarkuar të monitorojnë.³⁸⁶ Inspektimet dhe inventaret vështirësohen nga komunikimet e dobëta midis depove qendrore dhe rajonale, transportit të dobët, daljet në pension të personelit të aftë dhe të shënjave kineze dhe ruse në armë që shumë nuk mund t'i lexojnë.³⁸⁷ Gjatë ripaketimit të tij të municionit të pasistemuar sipas kontratës së NAMSA, QKÇ (Qendra Kombëtare e Çmilitarizimit) pa së pari se të dhënat e magazinës nuk përputheshin me realitetin.³⁸⁸ Nga vlerësimi i një ish zyrtari të NAMSA-s, inventaret janë rreth 90 për qind të sakta,³⁸⁹ dhe kështu krijojnë mundësi për shpërdorim nga ana e personelit ushtarak.³⁹⁰

Aktualisht, Forcat Tokësore, Forcat Detare, Komanda e Mbështetjes Logjistike dhe Forcat Ajrore Shqiptare, të gjitha përdorin të dhëna në letër sesa të dhëna të kompjuterizuara për të raportuar te Shtabi i Përgjithshëm mbi mbajtjet e armëve. Ky system është funksional, por i ngadaltë dhe duhet të përfitojë nga zhvillimi elektronik.³⁹¹ Sipas zyrtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes kërkohet një sistem me nyje qendrore të paktën në qendra për forcat tokësore, detare, mbështetjen logjistike dhe forcat ajrore së bashku me një pikë qendrore në Shtabin e Përgjithshëm.³⁹² Megjithatë, sipas të intervistuarve nga organizatat dhe kompanitë ndërkombëtare, Ministria e Mbrojtjes është siguruar me sistem paketash llogaritje të kompjuterizuara për mbajtjet e armëve të vogla dhe të lehta e municioneve, por ato nuk janë përdorur.³⁹³ Sugjerimi i një zyrtari ndërkombëtar është që baza e të dhënave që operon brenda Ministrisë së Brendshme (përshtetur më poshtë në seksionin 5.1.2.1) të mund të përshtatej për përdorim brenda Ministrisë së Mbrojtjes.³⁹⁴ Me mbështetjen e donatorit, shpresohet që ky sistem të mund të qarkullonte në çdo depo, me të dhënat e mbledhura për sasinë, tipet dhe shënjën e armëve të vogla dhe të lehta dhe pajisjeve ushtarake.

Disa shqetësime shfaqen në lidhje me AVL-të dhe municionet e depozituara në magazinat ushtarake nga ekipet e grumbullimit të armëve. Një vëzhgues

³⁸³ “ushtari që ruante repartin i akuzuar për vjedhje municioni”, Cështje të krimit dhe korrupsionit në Shqipëri, 9–15 korrik 2005. Burimi: *Shekulli*, 13 korrik 2005.

³⁸⁴ Qeveria e Shqipërisë, ‘Raport mbi zbatimin e Programit të Veprimit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e tregtisë së paligjshme të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta, në të gjitha aspektet e saj’, (2004), <http://disarmament2.un.org/cab/nationalreports/2003/Albania.pdf>, accessed 12 Nëntor 2005, fq 10.

³⁸⁵ Ibid.

³⁸⁶ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

³⁸⁷ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

³⁸⁸ Intervistë, ish zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 18 prill 2005.

³⁸⁹ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

³⁹⁰ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 23 Korrik 2005.

³⁹¹ Intervistë, ish zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 18 prill 2005.

³⁹² Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 14 prill 2005.

³⁹³ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 12 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 23 Korrik 2005.

³⁹⁴ Korrespondencë me zyrtar ndërkombëtar, 10 Nëntor 2005.

ndërkombëtar ka shprehur shqetësime se të dhënat mund të mos jenë të sakta sepse ata punonjës policie të ngarkuar me mbledhjen dhe regjistrimin e armëve dhe municionit të mbledhur mund të mos jenë në gjëndje të identifikojnë saktësisht çfarë është mbledhur.³⁹⁵ Ky skepticizëm rrjedh nga fakti se as policia që ka mbledhur armët dhe municionin, as menaxherët e policisë ose të magazinave ushtarake që i kanë marrë ato, nuk numërojnë çdo të copë të veçantë që ata marrin. Për më tepër, sic u deklarua më sipër, municioni dhe granadat mund të arrijnë të përziera së bashku në shishe, çanta ose kontenierë të tjerë, të cilët disa punonjës policie ose menaxherë magazine nuk janë të gatshëm t'i ndajnë. Pjesët e mbledhura të AVL-ve kanë të ngjarë të vështirësojnë organizimin e disa magazinave, si disa anëtarë të stafit të Ministrisë së Mbrojtjes i zbrazin këto pjesë në magazine ose për shkak se punonjësit teknikë nuk janë të pranishëm, ose të pashqetësuar me detyrën e trajtimi të armëve të mbledhura.³⁹⁶ Kështu, cdo shifër depoje në letër mund të jetë e ndryshme në kapjet e tyre të vërteta. Kjo gjithashtu lidhet me faktin se ekspertët ndërkombëtarë nuk e ndiejnë se shumë nga menaxherët e magazinës kanë patur trajnim të mjaftueshëm për punën.³⁹⁷

Ka probleme të mëtejshme me shpejtësinë e shkëmbimit të informacionit midis reparteve të largëta dhe depove dhe autoriteteve qëndore, të cilat mund të cënoheshin nga saktësia e shifrave. Për shëmbull, një menaxher magazine në një depo në Kukës mund të nxjerrë 1,000 të copë municioni për t'u përdorur në trajnim, por kjo mund të mos gjendet në një regjistër të Ministrisë së Mbrojtjes në qëndër derisa shumë më vonë, për shkak të sfidave që një sistem të dhënash i bazuar në letër dhe infrastruktura e dobët e transportit paraqesin për komunikimin efektiv dhe në kohë midis njësiteve. Këto vonesa mund të krijojnë mundësi për vjedhje në shkallë të vogël dhe llogari të rreme.³⁹⁸

Depot Model

Një i intervistuar sugjeroi se një depo model do të ngrihej si një zgjidhje afatgjatë për rezervat³⁹⁹ e tepërta ushtarake të Shqipërisë. Depoja model do të ishte tërësisht në përputhje me standartet e NATO-s, duke krijuar praktikën më të mirë në fusha si ripaketimi i municionit, kompjuterizimi i mbajtjes së të dhënave, përdorimi i inventareve fizike, ndriçimi, strehimi për rojat, dyert e përforcuara dhe televizori me qark të mbyllur. Kjo do të kërkonte asistencë ndërkombëtare dhe mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe fondet përkatëse. Me planet për të pakësuar numrin e grupdepove në Shqipëri, në pesë ose gjashtë, ndërtimi i të paktën një depoje model në planin afatshkurtër e afatmesëm duket të jetë një opsion i mirë për përmirësimin e sigurisë së rezervave në planin afatgjatë. Megjithatë, që një iniciativë fillestare e këtij lloji të ketë sukses, përvoja në kontekstet e tjera tregon se duhet të ketë gjithashtu një strategji intensive për të siguruar praktikën më të mirë që të filtrojnë edhe në depo të tjera. Kjo do të kërkonte mbështetje politike dhe buxhetore nga qeveria kombëtare, si dhe një plan të qartë zbatimi.

Kapaciteti i shkatërrimit

Në vitin 1998, NATO mblodhi një Ekip Zbatimi për Magazinimin dhe Asgjësimin e Municionit (ASDIT), që punonte nën kujdesin e Partneritetit për Paqe, për të identifikuar shkallën e AVL-ve dhe problemin e municioneve në Shqipëri. Një prej rekomandimeve të ASDIT ishte përmirësimi i trajnimit të forcave të armatosura në procedurat e Asgjësimit të Eksplozivëve të Artilerisë (AEA). Kështu, Skuadra e Trajnimit për Mbështetje ndaj Asgjësimit të Municioneve të Artilerisë (AEA ASTT, 1999–2002), skuadra e dytë e NATOS në kuadër të Partneritetit për Paqe e dërguar në Shqipëri, ishte ngarkuar me detyrën të siguronte konsulencë në lidhje me

³⁹⁵ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 21 prill 2005.

³⁹⁶ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

³⁹⁷ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

³⁹⁸ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

³⁹⁹ Intervistë, ish zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 18 prill 2005.

magazinimin dhe shkatërrimin e sigurt, duke formuar një ekip AEA brënda Forcave të Armatosura shqiptare, duke përfshirë 12 studentët e parë të kualifikoheshin nga kursi i trajnimit të NATO-s. 13 studentët e tjerë u trajnuan më pas, megjithëse si rrjedhojë e reformave në ushtri, shumë nga ata të trajnuar nga NATO dolën në pension, dhe mendohet të jenë vetëm dy të trajnuar të mirëfilltë të punësuar për detyra të AEA të forcave të armatosura që janë trajnuar vetëm për shkatërrimin e zërave të veçanta, bëjnë shkatërrime në shkallë të gjërë, pa njohuritë ose pajisjet e nevojshme, duke paraqitur kështu një rrezik të konsiderueshëm ndaj sigurisë publike.⁴⁰⁰

Në u informuam se shumë nga personeli i punësuar në uzinat ushtarake të Gramshit, Mjekesit dhe Poliçanit tashmë zhvillojnë kryesisht çmontime xhenjere dhe projekte çmilitarizimi mbi pajisjet⁴⁰² e tepërta ushtarake. Ekipi studimor gjithashtu vizitoi bazën ushtarake të Mengelit, afër Elbasanit, e cila ishte përdorur si vënd shkatërrimi i AVL-ve për një numër projektsh shkatërrimi të armëve të vogla dhe të lehta të financuara nga ndërkombëtarët. Një workshop i prerjes së AVL-ve u krijua aty në vitin 2000 nga një ekip ushtarak gjerman i ngarkuar me detyrën e shkatërrimit të 40,000 armëve të vogla dhe të lehta, i cili dhuroi pajisje prerëse dhe pajisje kompjuterike për mbajtjen e të dhënave.⁴⁰³ Vendi u përdor më pas nga EOD Solutions për të shkatërruar edhe 85,000 AVL. Sipas stafit në bazë, ata kanë kapacitetin të shkatërrojnë mesatarisht 600 AVL në ditë. Ky vend më pas iu dorëzua qeverisë shqiptare për projekte të shkatërrimit të vazhdueshëm, me shpresa se do të mund të shërbejë si vënd për shkatërrim e stoqeve të armëve të vogla e armatimeve të lehta nga shtetet fqinje.

Në vjeshtën e vitit 2005, një qendër shkatërrimi municioni në përputhje me standartet e Bashkimit Europian ishte gati të funksiononte në Uzinën e Lëndëve Plasëse ULP Mjekes.⁴⁰⁴ NATO kishte siguruar, sipas të dhënave, 2.5 milion \$ për instalimin e kësaj njësie, megjithëse një sërë pengesash e kishin vonuar datën e fillimit të krematoriumit.⁴⁰⁵ Sipas përfaqësuesve të NAMSA-s, krematoriumi do të përdoret për shkatërrimin e rreth 11,000 tonësh municion AVL gjatë 18 muajve të ardhshme, me një nivel mesatar prej 22,500 7.62 mm shtimje për orë. Pritet të operojë për 24 orë në ditë, me fishekë të çmilitarizuar që janë dërguar në punimet e shkrirjes së metalit diku afër Elbasanit.⁴⁰⁶

Strategjia e Municioneve të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila u zhvillua nga MEICO në vitin 2004, paraqet planet e forcave të armatosura shqiptare për asgjësimin e municioneve të tyre të tepërta, duke specifikuar prioritetet, metodat dhe kostot e shkatërrimit. Megjithëse strategjia pret miratimin formal dhe nuk është plotësisht e financuar, po përdoret sipas raporteve për të drejtuar punën në këtë fushë.⁴⁰⁷ Në vitin 2000, forcat e armatosura shqiptare llogaritën se magazinat e tyre përmbanin një tepriçë prej 117,476 tonësh municion.⁴⁰⁸ Kjo shifër u ul në 85,424 nga fundi i vitit 2004 si rezultat i aktiviteteve të shkatërrimit të kryera nga forcat e armatosura shqiptare, EOD Solutions shpk, NAMSA dhe NDC. Gjatë periudhës 2001–2004, forcat e armatosura shqiptare shkatërruan 26,473 tonë municione, NAMSA shkatërroi 2,874 tonë mina antipersonel dhe 1,475 tonë municion, dhe EOD Solutions shpk shkatërroi 1,229 tonë municion. Është llogaritur se forcat e armatosura shqiptare do të shkatërrojnë edhe 11,780 tonë dhe EOD Solutions 1,000 tonë gjatë vitit 2005.⁴⁰⁹ Në vitin 2006, NAMSA synon të shkatërrojë 8,000 tonë shtesë si pjesë e një granti prej €6.4

⁴⁰⁰ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005; ish zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 18 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

⁴⁰¹ Korrespondencë me kontraktues privat, tetor 2005.

⁴⁰² Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005; zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 29 korrik 2005; zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 korrik 2005.

⁴⁰³ Të dhëna të mbledhura gjatë vizitës në bazën ushtarake të Mengelit, 27 korrik 2005.

⁴⁰⁴ Të dhëna të mbledhura gjatë vizitës në uzinën e lëndëve plasëse në Mjekes, 27 Korrik 2005.

⁴⁰⁵ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

⁴⁰⁶ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 27 korrik 2005; Zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 korrik 2005.

⁴⁰⁷ Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 17 mars 2005.

⁴⁰⁸ Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 14 prill 2005.

⁴⁰⁹ Intervista, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 14 prill 2005.

milion të siguruar nga Fondi⁴¹⁰ i Natos në kuadër të Partneritetit për Paqe. Kështu, bazuar në nivelet aktuale, Shqipëria ende do të ketë të paktën 60,000 tonë municione të tepërta për t'u shkatërruar pas mbarimit të projekteve aktuale në 2006.

Tabela 25: Municionet e shkatërruara dhe përdorura nga viti 2000–prill 2004⁴¹¹

Vendndodhja/Viti	2000	2001	2002	2003	Jan–Prill 2004	Totali
Uzina ushtarak i Poliçanit	400 tonë	2,300	2,085	4,600	853.8	10,238.8
Uzina Ushtarake e Gramshit				804	169.3	973.3
Uzina Ushtarake e ULP-Mjebes		2,186	688	35	307	3,216
Grupi shqiptar i AEA	63	468	671	2,837	2,436	6,475
EOD Solutions shpk.			894	2	34	930
NDC				352		352
Shtimjet e harxhuara	200	180	150	100		630
Totali	663	5,134	4,488	8,730	3,800.1	22,815.1

Pjesa e Strategjisë së Municioneve merret me ripaketimin e municionit të gatshme për asgjësim. Sic u përmënd diku tjetër në këtë raport, shumë nga municionet e mbledhura nga MB dorëzohet në magazinat e Ministrisë së Mbrojtjes në të njëjtat kushte sic arrin në rajonet e policisë. Kjo mund të nënkuptojë që çantat plastike dhe shishet e lira dhe llojet e përziera të municioneve mbahen në magazinat e Ministrisë së Mbrojtjes derisa të mund të ripaketohen dhe të ndahen për shkatërrim të sigurt. Kështu, ka nevojë për një staf teknikisht të aftë që të ndajë municionin e mbledhur në pako të sigurta për shkatërrim. Fakti që një përqindje e konsiderueshme e AVL-ve të mbledhura, municionit dhe eksplozivëve janë përzgjedhur për shkatërrim sesa për shitje, duhet të njihet si një hap pozitiv nga komuniteti ndërkombëtar. Një mbështetje e mëtejshme ndërkombëtare për projektet e shkatërrimit do t'i dërgonte autoriteteve shqiptare një mesazh pozitiv inkurajimi.

Megjithëse jo domosdoshmërisht një çështje që i përket AVL-ve dhe shkatërrimit të municionit të AVL-ve, një numër të intervistuarish theksuan problemet që Ministria e Mbrojtjes dhe kontraktuesit ndërkombëtarë përballen kur përipiqen të rregullojnë një shkatërrim të sigurt të minave, municioneve të kalçibrit të madh dhe armatimeve⁴¹² të tjera. Shqipëria po shkatërron rreth 300–400 tonë municione në muaj.

Njëkohësisht, çështjet mjedisore po fitojnë rëndësi pasi njerëzit po bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjësuar në lidhje me to. Shkatërrimet tashmë po ngadalësohen nga protestat.⁴¹³ Ministria e Mbrojtjes dhe kontraktuesit ndërkombëtarë duhet të marrin leje nga autoritetet lokale për të përdorur vëndet që ishin më parë pronë e Ministrisë së Mbrojtjes për të shkatërruar municione dhe materiale ushtarake të tepërta nëpërmjet detonimit. U raportua se nuk ka shumë konsulentë lokalë që janë të gatshëm të nënshkruajnë marrëveshje që lejojnë shkatërrimin e materialeve ushtarake në zonat e tyre, për shkak të protestave dhe fushatave kundër vëndeve të shkatërrimit. Disa nga këto fushata dhe protesta kanë theksuar dëmin mjedisor të shkaktuar nga shkatërrimi i municioneve, por shumica mendohen të jenë të motivuar nga frika se projektet e shkatërrimit do të kenë impakt mbi jetesën e banorëve të zonës. Për shëmbull, disa fermerë janë ankuar se ujësjellësi i tyre është ndotur pas detonimeve në zonën e tyre ose raportuan forma të tjera dëmi të pronës ose gjësë së gjallë. Ndërsa protesta mund të ngadalësojnë aplikimet për liçensa për të shkatërruar armët, ato nuk e kanë ndaluar procesin e shkatërrimit.

Zyrtarë të Ambasadës Amerikane në Tiranë sugjeruan se pjesë e problemit është edhe

⁴¹⁰ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

⁴¹¹ Qeveria e Shqipërisë, 'Raport mbi zbatimin e Programit të Veprimit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e tregtisë së paligjshme të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta, në të gjitha aspektet e saj', (2004), <http://disarmament2.un.org/cab/nationalreports/2003/Albania.pdf>

⁴¹² Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 18 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 29 Prill 2005; zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 17 Mars 2005; zyrtar ndërkombëtar, 19 Prill 2005; parlamentar, 3 Maj 2005; zyrtar ndërkombëtar, 23 Korrik 2005.

⁴¹³ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 Prill 2005.

metoda e ndjekur nga Ministria e Mbrojtjes. Ata argumentojnë se Ministria e Mbrojtjes nuk është mjaft kompetente në detyrat e marrëdhënieve publike dhe kështu mund të krijojë ose përkeqësojë disa nga problemet të cilat ata ndeshin përmes një përzierjeje arrogance dhe indiferentizmi kundrejt popullsisë lokale. Nuk kanë ndihmuar as një sërë ‘aksidentesh’. Ekipit studimor iu shpjegua se për t’u siguruar se procesi po ecën sic duhet, është e nevojshme të sigurohet se janë krijuar marrëdhënie të mira personale me zyrtarët lokalë. Për Ministrinë e Mbrojtjes ose kontraktuesit ndërkombëtarë, për të marrë një leje për të shkatërruar pajisje ushtarake, autoritetet lokale zakonisht kanë nevojë të risigurohen dhe ndoshta të marrin stimuj për të qënë dakord. Komiteti Parlamentar i Mbrojtjes ka qënë, sipas të dhënave, i përfshirë në një sërë rastesh, sepse banorët lokalë pretendojnë se apelimi i tyre bie në vesh të shurdhër, kur ata i drejtohen Ministrisë së Mbrojtjes me ankesa.⁴¹⁴

Një nga problemet kryesore për projektet e shkatërrimit i ndërmarrë në mjediset ushtarake shqiptare është që shkatërrimi i municionit po bëhet gradualisht më i vështirë meqë shumë pjesë më të lehta dhe më fitimprurëse për t’u çmilitarizuar, janë shndërruar tashmë në metale skrap dhe janë shitur. Pjesa që mbetet, e cila përfshin Granada mortajë, artileri e kalibrit të mesëm dhe municione të tjera që janë teknikisht të vështira për t’u shkatërruar, do të jetë më e vështirë të shiten me një cmim që mbulon koston e çmilitarizimit, pa përmendur me një përfitim. Një rënie e interesit të donatorit ndërsa kostoja për çdo pjesë për çmilitarizimin rritet, ka shkaktuar probleme. Kështu, u krijua frika se mos njësitë e çmilitarizimit në Gramsh, Mjebes dhe Poliçan do të mund të ndalonin punën në një të ardhme të afërt, pasi ato do të kenë çmilitarizuar të gjitha stoqet e tepërta që mund të shiten aktualisht si skrape.⁴¹⁵ Njëkohësisht, pajisje të tjera të rënda ushtarake të tepërta konsiderohen prioritare për t’u shkatërruar. Për shëmbull, SHBA e përqëndroi financimin e saj në shkatërrimin e MANPADS në 2004 dhe tashmë po thekson programet e shkatërrimit për armët kimike, minat detare dhe silurët.⁴¹⁶

5.1.1.3 MEICO dhe sistemi i kontrollit të transfertave

Vetëm një ndërmarrje shqiptare lejohet aktualisht në mënyrë të ligjshme të tregtojë armë, municione dhe pajisje ushtarake. Kompania shtetërore ushtarake e import-eksportit (MEICO) u krijua në vitin 1991 dhe është e atashuar brenda Ministrisë së Mbrojtjes. Është përgjegjëse për marketingun dhe shitjet e armëve dhe pajisjeve ushtarake të tepërta shqiptare dhe importimin e pajisjeve ushtarake dhe armëve të zjarrit për të gjitha institucionet shtetërore shqiptare. Detyra e saj kryesore është të pakësojë armët dhe municionet e tepërta të forcave të armatosura shqiptare nëpërmjet transfertave ndërkombëtare, duke rritur kështu të ardhurat për modernizimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Kur u krijua MEICO, Ministria e Mbrojtjes mori leje nga qeveria për ditën e shitjes, shkatërrimit ose çmontimit dhe shitjes si skrap të stoqeve shtetërore të armëve dhe municioneve të tepërta.⁴¹⁷ Aktivitetet e saj udhëhiqen kryesisht nga dokumentat e mëposhtëm:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 366, “Mbi krijimin e ndërmarrjes së import-eksportit [në varësi] të Ministrisë së Mbrojtjes”, 5 tetor 1991;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 135, “Mbi miratimin e shitjes së armëve dhe municioneve nga Ministria e Mbrojtjes”, 1 maj 1992;
- Ligji Nr. 7566, “Mbi armët”, 25 maj 1992;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 365, “Mbi shkatërrimin ose shitjen e municioneve për të cilat po përfundon ose ka përfunduar periudha e përdorimit dhe mbi shitjen e

⁴¹⁴ Intervista, parlamentar, 3 Maj 2005.

⁴¹⁵ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 18 Prill 2005.

⁴¹⁶ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 29 Prill 2005.

⁴¹⁷ Ibid.

armatimeve dhe municioneve të tepërta “, dhe amendimet e tij, 6 qershor 1994;⁴¹⁸

- Rregullorja e Qeverisë Shqiptare Nr 366, “Mbi shitjen e armatimeve dhe municionit”, 10 gusht 1996;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 05, “Mbi funksionimin e kompanisë ushtarake të import- eksportit, MEICO, dhe marrëdhëniet e saj me departamentet dhe njësitë e tjera në Ministrinë e Mbrojtjes “, 08 janar 2002;

Sipas këtij vendimi të fundit, MEICO mund të importojë dhe eksportojë të gjitha llojet e pajisjeve ushtarake, municionit dhe eksplozivëve⁴¹⁹ industrialë dhe ushtarakë dhe konsiderohet si pika kryesore e kontaktit për partnerët e huaj të interesuar për lidhjen e marrëveshjeve të armëve me palët shqiptare.⁴²⁰ Gjithashtu vë përgjegjësinë për koordinimin e marrëdhënieve midis MEICO-s dhe departamenteve të tjera të Ministrisë së Mbrojtjes me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.⁴²¹ Kur Ministria e Brendshme (MB) importon pajisje ushtarake, duhet të veprojë nëpërmjet MEICO-s.⁴²² Që në fillim të vitit 2003, MEICO-s i është kërkuar të dërgojë një raport të detajuar dhe konfidencial të aktiviteteve të saj Presidentit, Kryeministrit, Zyrës Kombëtare të Auditit dhe Ministrisë së Mbrojtjes në datën 15 të çdo muaji.⁴²³ Aktualisht ka një staf prej mbi njëzet vetash që punojnë në sektorin e financës, marketingut, ligjit dhe fushave teknike që kanë lidhje me pajisjet ushtarake dhe armët e zjarrit.⁴²⁴ Pretendohet nga drejtuesi i kompanisë se MEICO nuk ka privilegje speciale kur është fjala për përmbushjen e kërkesave të vendimeve qeveritare, rregulloreve dhe urdhrave mbi transferimet dhe që në fakt “doganat vënë kompanitë private përpara MEICO-s, duke shkaktuar vonesa⁴²⁵ serioze”.

Aktualisht, vetëm MEICO ka të drejtë të apikojë për licensë për të importuar ose eksportuar një ngarkesë të pajisjes ushtarake, AVL dhe/ose municione. Ata duhet të bëjnë një aplikim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes për cdo urdhër, i cili më pas vlerësohet nga Drejtoria e Integritetit të Politikave në Ministrinë e Mbrojtjes, në konsultim me ministrinë e tjera dhe nganjëherë me ambasadën angleze dhe amerikane në Tiranë. Më pas, licensa nxirret sipas një dekreti të nxjerrë nga Ministri i Mbrojtjes, mbi autoritetin e qeverisë.⁴²⁶

Në rastin e eksporteve të pajisjeve të tepërta ushtarake, aplikimet duhet të kalojnë para një komisioni për vlerësimin e informacionit mbi shkatërrimin e armëve, i cili miraton tipin, peshën dhe sasinë e municioneve që do shiten dhe çmimin e shitjes.⁴²⁷ Komisioni drejtohet nga drejtori i Drejtorisë së Logjistikës dhe përfshin anëtarët e mëposhtëm:

- Shefin e sektorit të armatim- municionit;
- Një specialist i sektorit të armatimit;
- Një përfaqësues i sektorit për ndërmarrjet ushtarake;
- Një përfaqësues i drejtorisë së planifikimit dhe financës;
- Një përfaqësues i institutit të projektimit në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Një përfaqësues i MEICO-s.

Sipas urdhrat të qeverisë që krijoi këtë komision, vendimet mbi urdhrat duhet të

418 Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 822, “Mbi amendimin e vendimit të Këshillit të Ministrave No. 365”, 9 Dhjetor 1996; Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 564, “Mbi një amendim të vendimit të Këshillit të Ministrave No. 365”, 22 Dhjetor 1997; Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 829, “Mbi një amendim të vendimit të Këshillit të Ministrave No. 365”, 30 dhjetor 1998; Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 344, “Mbi një amendim të vendimit të Këshillit të Ministrave No. 365”, 7 korrik 2000; Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 113, “Mbi një amendim të COM Decision No. 365”, 8 mars 2001; Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 17, “Mbi një amendim të vendimit të Këshillit të Ministrave No. 365”, 28 janar 2002; Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 1, “Mbi një amendim të vendimit të Këshillit të Ministrave No. 365”, 10 janar 2003.

419 Neni 3 i Vendimit të Këshillit të Ministrave No. 05, “Mbi funksionimin e kompanisë ushtarake të import- eksportit, MEICO, dhe marrëdhëniet e saj me departamentet dhe njësitë e tjera në Ministrinë e Mbrojtjes, 8 janar 2002.

420 Neni 5 i vendimit të Këshillit të Ministrave No. 05, “Mbi funksionimin e kompanisë ushtarake të import- eksportit, MEICO, dhe marrëdhëniet e saj me departamentet dhe njësitë e tjera në Ministrinë e Mbrojtjes, 8 janar 2002.

421 Neni 6 i vendimit të Këshillit të Ministrave No. 05, “Mbi funksionimin e kompanisë ushtarake të import- eksportit, MEICO, dhe marrëdhëniet e saj me departamentet dhe njësitë e tjera në Ministrinë e Mbrojtjes, 8 janar 2002.

422 Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.

423 Urdhri No. 27 “Mbi informacionin rreth armëve dhe municioneve të tepërta në aktivitetet e import- eksportit të MEICO-s”, 23 Janar 2003.

424 Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.

425 Po aty.

426 Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 prill 2005.

427 Urdhri No. 556, “Mbi krijimin e në Komiteti për vlerësimin e informacionit të marrë në lidhje me shkatërrimin e armëve, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave No. 617”, 10 Dhjetor 2003.

merren brënda një muaji nga kërkesat për shitje.

Në vitin 2003, u prezantua një rregullore që kërkonte që të gjitha aplikimet për licensë për të importuar ose eksportuar pajisje ushtarake dhe armë për të përfshirë një certifikatë të përdoruesit të fundit (end-user në gjuhën angleze) detaje për kompaninë dhe/ose shtetin e eksportit ose importit dhe një kopje të kontratës.⁴²⁸ Certifikatat për verifikimin e dërgesës përdoren tashmë në shumë raste dhe megjithëse nuk është ende një kërkesë ligjore,⁴²⁹ është krijuar për t'u bërë e tillë sipas ligjit të propozuar mbi kontrollet e eksportit.⁴³⁰

Këto licensa lëshohen rast pas rasti dhe kanë tendencën të jenë të kufizuara për tregti me një vend të specifikuar për një periudhë të specifikuar kohe. Sipas drejtuesit të MEICO-s, pamundësia për të siguruar një certifikatë të kënaqshme end-useri është arsyeja më e shpeshtë për mohimet⁴³¹ e kohëve të fundit të licensave. Ministria e Mbrojtjes kontrollon cdo aplikim me MPJ-në, e cila zakonisht informon Ministrinë e Mbrojtjes brënda dhjetë ditësh nëse marrësi po bën një embargo ose transferta paraqet rrezik të lartë diversioni ose kërcënim ndaj sigurisë kombëtare ose ndërkombëtare. Megjithatë, ka shqetësime se Shqipëria nuk ka kapacitetet e kërkuara për të kontrolluar përputhshmërinë me end-userat dhe certifikatat e verifikimit të dërgesës për shkak të përfaqësimit të saj të kufizuar përtej detit. Kështu, autoritetet shqiptare kanë kërkuar asistencë nga përfaqësitë diplomatike angleze ose amerikanë në vendet e destinacionit.

Sipas drejtuesit të MEICO-s janë bërë kontrolle mbi ndërmetësit dhe kompanitë e tjera të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në transfertë.⁴³² Nëse është përfshirë një ndërmjetës, ata do të duhet të paraqesin dokumentacioni që tregojnë se ata janë regjistruar në shtetin e tyre amtar si një entitet tregtar dhe i licensuar për të vepruar si një broker i palës së tretë. Nëse ka probleme me aplikimin, atëherë licensa e transferit do të mohohet nga Ministria e Mbrojtjes. Drejtuesi i MEICO-s informoi ekipin studimor se ata tashmë përpiqen të shmangin marrëveshjet me brokerat dhe agjentët si palë të treta, duke preferuar të lidhin marrëveshje sipas mundësisë mbi një bazë shtet-me-shtet.⁴³³ Megjithatë, kompanitë dërguese, siguruesit, financierët dhe palët e tjera të përfshira në tregtinë e armëve nuk kanë nevojë të regjistrohen ose licensohen për të marrë pjesë në transfertë. Nuk ka kompani shqiptare të regjistruara të njohura si moderatorë logjistikë dhe të transportit të pajisjeve ushtarake.

Aktualisht, Shqipëria nuk ka një sistem regjistrimi për brokerat. Megjithatë, me hyrjen në fuqi të ligjit të propozuar mbi kontrollet e eksportit, kjo do të ndryshojë. Ligji i ri do të krijojë mundësinë për firmat private shqiptare të regjistruara të operojnë në tregun e armëve si importues, eksportues ose broker dhe të lejojë transferimin e mallrave në vënd.⁴³⁴ Nga zhvillimet vëzhguese përgjatë kufirit në Greqi, drejtuesi i MEICO-s është shprehur se ndërsa ai e mirëpret hyrjen e kompanive private që operojnë në tregun e armëve nga Shqipëria, ai është i preokupuar se brokerat paraqesin mundësi më të mëdha për praktika korruptive dhe ngarkesa të paligjshme.⁴³⁵ Ai do preferonte që aktivitetet e brokerimit në Shqipëri të ndaloheshin. Kjo padyshim lidhet me faktin se njihet që kontrollet e zbatimit në këtë sferë mund të ishin shumë të vështira për autoritetet shqiptare. Siç deklaroi një parlamentar, në Shqipëri gjendet legjislacioni i mirë, por ka pikëpyetje nëse Shqipëria ka kapacitetin e duhur për ta zbatuar atë.⁴³⁶

⁴²⁸ Rregullorja No. 9603, "Mbi përpilimin dhe dokumentimin e aktivitetëve të import-eksportit [në lidhje me] pajisjet ushtarake", 18 Shtator 2003. Neni 6 deklaron se licensat, lejet e import-eksportit dhe certifikatat e end-userave nuk mund t'i transferohen palëve të tjera. Nëse gjykohet se janë bërë shkelje të rregullores, atëherë licensat, lejet e import-eksportit dhe certifikatat e end-userave mund të anulohen. Neni 8 jep të drejtën për apel.

⁴²⁹ Një përjashtim ndaj këtyrë rregullit janë njanjëherë eksportet e armëve trofe për në SHBA.

⁴³⁰ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.

⁴³¹ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.

⁴³² Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.

⁴³³ Kjo mund të jetë për shkak të faktit se disa ngarkesa të armëve dhe municioneve të blera nga MEICO nga kompani private kanë gjetur rrugën e tyre në rajonet në konflikt. Për shëmbull, një raport eksporti i vitit 2003 drejtuar Shërbimeve të Mbrojtjes Mbretërore me seli në Mbretërinë e Bashkuar mendohet të jetë shitur te palët ndërluftuese në Afrikë dhe ne u informuam gjithashtu për një shitje të një broker ciftut që gjithashtu u divert. Intervieë, Zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.

⁴³⁴ Intervieë, Zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.


⁴³⁵ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.

⁴³⁶ Intervista, parlamentar, 3 maj 2005.

5.1.1.4 Transfertat

Të dhënat mbi transaksionet e MEICO-s të cilat ekipi studimor ishte në gjëndje t'i përpilonte janë larg nga ajo çka do përbënin një vlerësim gjithëpërfshirës të aktiviteteve të agjencisë gjatë viteve të fundit. Të dhënat përfshihen në Shtojcën A. Transaksioni i eksportit i listuar aty për periudhën 1992–2004 ka një vlerë të kombinuar prej 16,312,407\$. Nuk kemi asnjë të dhënë për periudhën 1996–1999. Një i intervistuar nga MEICO sugjeroi se Gjermania dhe SHBA kanë qënë destinacionet kryesore për armët dhe municionet e tepërta shqiptare me shumë nga këto shitje të lidhura me armët trofe ose municionet për armët trofe.⁴³⁷ Për shëmbull, midis vitit 2000 dhe gjysmës së parë të vitit 2005, rreth tridhjet milion fishekë për gjueti dhe armë trofeje u eksportuan në SHBA. Sipas zyrtarëve në ambasadën amerikane, MEICO tani kontakton me ambasadën para eksporteve ose importeve autorizuese që përfshijnë kompanitë amerikane ose që kanë SHBA si destinacion.⁴³⁸ Në vitin 2004, 200 armë trofe u eksportuan në Gjermani.⁴³⁹ Ndërsa të dhënat nga MEICO konfirmojnë SHBA/Kanadanë si marrësin kryesor të mallrave gjatë viteve të fundit, ajo thekson gjithashtu marrës të tjerë për materiale shqiptare si Sudanin, Turqinë dhe Ajzerbaxhanin, sic tregohet në grafikun e mëposhtëm.

Marrësit e eksporteve shqiptare 1992–2004 (burimi: tabela në shtojcën 1)



Nga raportimet, në vitin 2002, Shqipëria dërgoi armë dhe municione për të rifurnizuar ushtarakët⁴⁴⁰ afganë. Sipas një raporti lajmesh, transfertat në Afganistan përfshinë 10,000 të copë municion, 600 Kalashnikovë dhe një numër të pazbuluar automatikësh dhe mortajash.⁴⁴¹ Ka tashmë plane për tepricat ushtarake shqiptare që të dërgohen për të ndihmuar rifurnizimin e forcave të sigurisë së Irakut, me një kontratë të rregulluar në vitin 2004 për të dërguar një milion fishekë në 2005, me disa miliona më shumë që do të dërgohen në vitet e mëvonshme.⁴⁴²

Të dhëna nga NISAT nuk e kundërshtojnë domosdoshmërisht të dhënat e MEICO-s në lidhje me vlerën e përgjithshme të eksporteve të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta në ndonjë vit të caktuar, sic e demonstroi grafiku i mëposhtëm. Edhe për vitin 2001, ku vlera e eksporteve e regjistruar nga NISAT i tejkalon shifrat e MEICO-s, vetëm \$1,194 nga \$449,931 të eksporteve njihen të kenë përbërë tërësisht armët e vogla dhe armatimet e lehta.

⁴³⁷ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.


⁴³⁸ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 29 prill 2005.

⁴³⁹ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.


⁴⁴⁰ Intervista, zyrtar i qeverisë britanike, 21 prill 2005.

⁴⁴¹ 'Ministria shqiptare e Mbrojtjes konfirmon dhurimin e pushkëve luftarake për ushtrinë afgane', AFP (Paris), 28 Nëntor 2002. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <<http://ëëë.nisat.org/>>, 17 Maj 2005.

⁴⁴² Intervista, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.

mijra **Vlerat e njohura të eksporteve të AVL-ve nga Shqipëria në të gjitha vëndet 1992–2004**

Mund të vërehet nga të dhënat e NISAT-it se katër nga marrësit e listuar (Italia, Islanda, Rumania, Austria) nuk ishin përdorur si marrës në të dhënat e MEICO-s të përpiluara nga ekipi kërkimor për këtë periudhë. Dukshëm, me të dhënat për disa vite që mungojnë nga të dyja burimet dhe një numër pyetjesh të ngritura rreth trasnfertave shqetësuese gjatë viteve të fundit (diskutuar më poshtë, mbeten boshllqe të konsiderueshme në atë se çfarë dihet rreth eksportit të armëve shqiptare që prej rënies së komunizmit).

Përfituesit e eksporteve shqiptare në periudhën 1996–2003 (Burimi: www.nisat.org)

Shënim: shifrat e NISAT-it mund të përfshijnë disa zëra që nuk kanë lidhje me AVL-të

Shqipëria nxjerr një numër shumë të vogël licensash importi dhe/ose eksporti në vit. Për shëmbull, në vitin 2004 janë nxjerrë tre licensa për eksport dhe njëra është refuzuar, ndërsa dy licensa për import janë pranuar.⁴⁴³ Refuzimi është bërë pasi në kompani bullgare që dëshironte të blente eksploziv TNT shqiptar nuk paraqiti të gjitha dokumentat e kërkuara dhe nuk mund të shpjegonte përse eksplozivët që po bliheshin dhe kishin si destinacion Malin e Zi duhet të kalonin nëpër Bullgari. Në vitin 2005 deri në 20 prill vetëm një leje është dhënë për eksportin e 4 milion rounds municioni në Irak.⁴⁴⁴ Eksportet e njohura gjatë viteve të fundit përfshijnë si më poshtë:

- Në 2004 10 milion copë municion u eksportuan në Irak;
- Në 2004 10 tonë eksploziv TNT u eksportuan në Bullgari në shkëmbim të eksplozivëve industrialë;

⁴⁴³ Intervista, zyrtari i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.

⁴⁴⁴ Intervista, zyrtari i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.

- Në 2004 200 items trofe u eksportuan në Gjermani;
- Në 2003 10 milion copë municion u eksportuan në SHBA.⁴⁴⁵

Për sa i përket importeve, një sasi e konsiderueshme armësh dhe municioni gjahu dhe sportive duken të kenë qënë importuar nga shtete të ndryshme, nga të cilat partnerët më të mëdhenj tregtarë në këtë fushë nga periudha 1996–2002 duken të jenë: Kina, Qipro, Gjermania, Greqia, Italia, Rusia dhe Turqia (shih tabelën). Sipas drejtorit të policisë në aeroportin e Rinasit, shumica e armëve të importuara ligjërishit që hyjnë në Shqipëri nëpërmjet aeroportit të Rinasit janë pushkë gjahu nga Turqia.⁴⁴⁶ Ai raportoi se 1,683 pushkë gjahu janë importuar ligjërishit në Shqipëri në vitin 2005, megjithëse ai nuk ishte në gjëndje të jepte të dhëna për vitet e mëparshme.

5.1.1.5 Transferta me probleme

Midis 1992 dhe 1997 MEICO mbikqyri eksportet e shumë destinacioneve që ndodheshin në vëndet e listave të zeza⁴⁴⁷, ashtu siç para vitit 1997 kur në fakt çdo eksport e merrte autorizimin në kontekstin ku për këtë çështje kërkohej vetëm një firmë, dhe dokumentat e nevojshme ishin në dispozicion, “nëse çmimi ishte i arsyeshëm” (ose citoj atë duke thënë këtë shprehje ose perifrziej).⁴⁴⁸ Rasti më i turpshëm i një dërgese nga Shqipëria me armë dhe municione ndaj një shteti, që u zbulua në kohën që ky shtet ishte nën embargon e OKB-së, ka të bëjë me çështjen e kompanisë nga Mbretëria e Bashkuar me emrin Mil-Tec⁴⁴⁹ që furnizoi pajisje ushtarake nga Shqipëria për forcat Qeveritare në Ruanda, shtet i cili ishte i dyshuar se ishte përfshirë në masakrën e fiseve Tutsis në 1994. Në vitin 1996, Ministria e Mbrojtjes shqiptare lëshoi një deklaratë ku theksonte: “Shqipëria nuk ka thyer asnjëherë ndonjë embargo të OKB-së. Ajo gjithmonë ka respektuar dhe do të vazhdojë të respektojë të gjitha organizmat ndërkombëtarë dhe vendimet e tyre. Shqipëria nuk është pëfshirë asnjëherë në raste të kontrabandës apo të trafikeve të paligjshme”.⁴⁵⁰ Megjithatë, ka qenë e rekomanduar që të gjashtë dërgesat me armë e municione që u eksportuan nga Shqipëria në Zaire, me marrëveshje ndërmjetësimi nga ana e Mil-Tec në 1994, të shkonin në Ruanda.⁴⁵¹ Në kohën e këtyre dërgesave, Zaire nuk ishte nën embargon e OKB-së, por “kërkimet nga ana e organizmave të ndihmës humanitare, nga OKB-ja, dhe nga gazetarët e ndryshëm nuk kanë rezultuar që ndonjë firmë tjetër përveç asaj me emrin Mil-Tec të ketë kryer furnizime me armë nga Albania në Ruanda në vitin 1994”.⁴⁵² Niveli i njohjes nga ana e autoriteteve të larta shqiptare mbi këto diversione për këtë kohë është ende i paqartë.

Situata ka ndryshuar ndjeshëm që prej asaj kohe: nga disa të intervistuar është shprehur mendimi që prezenca ndërkombëtare në Ministrinë e Mbrojtjes dhe angazhimi i sinqertë i Qeverisë Shqiptare për të paraqitur një imazh të mirë ndërkombëtar në fushën e kontrollit të transfertave të tilla, rekomandon që transferta të tilla ndaj vendeve përdorues të fundit (end-users) të papërgjegjshëm nuk ka gjasa që të ndodhin me mbështetjen e Qeverisë.⁴⁵³ Megjithatë, përbën një shqetësim të konsiderueshëm fakti që armët shqiptare kanë vazhduar të dërgohen apo të transferohen fshehurazi gjatë kohëve të fundit në rajonin e Liqeneve të Mëdha të Afrikës. Ky shqetësim bëhet më i madh edhe për faktin që interesi publik për këtë çështje është i vogël, dhe mbështetja dhe mbrojtja për gazetarë e tipit investigues mungon, gjë që rekomandon se përmasat e transfertave të tilla ka pak të ngjarë që të jenë eksploruar në detaje apo të jetë raportuar mbi gjëndjen reale e tyre.

⁴⁴⁵ Intervista, zyrtari i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.

⁴⁴⁶ Intervistë, Sadria, 20 Korrik 2005.

⁴⁴⁷ Intervistë, Zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.

⁴⁴⁸ Intervistë, Zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.

⁴⁴⁹ Mil-Tec ishte inkuorporuar në Douglas, në Isle of Man, i cili është një territor në vartësi të Kurorës së Mbretërisë së Bashkuar.

⁴⁵⁰ ‘Ministria përgënjeshtroi përfshirjen në dërgimin e armëve në Ruanda’, Tirana ATSH, në Anglisht, 2047 sipas kohës së Greenëitchit, 19 Nëntor 96, [Tekst i transkriptuar nga FBIS]. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005.

⁴⁵¹ Marrë nga një letër dërguar gazettes *The Guardian* nga Kate Allen e Amnesty International UK dhe Stewart Wallis i Oxfam-it. Shih: Gazetën *The Guardian*, 1 mars 2000, faqe 23.

⁴⁵² Wells M, ‘Firma të Armëve të lidhura me shefin e ushtrisë së Ruandës’, *The Guardian*, 10 Shkurt 2000, faqe. 8.

⁴⁵³ Intervistë, zyrtari ndërkombëtar i 19 Prill 2005.

Në korrik 2005, shtypi Britanik raportoi mbi diversione të pajisjeve ushtarake nga Shqipëria në konfliktin e Republikës Demokratike të Kongos (RDK) nëpërmjet Ruandës, të cilat kishin ndodhur në vitin 2002 dhe në 2003. Sipas Jon Swain dhe Brian Johnson-Thomas, MEICO i shiti municione një kompanie izraelite, e cila e rregulloi transportimin e më shumë se 250 tonë armë dhe municione të dërgohen duke përdorur African International Airways (AIA) nga Tirana në kryeqytetin e Ruandës, Kigali.⁴⁵⁴ Sipas raportit, shoqëria e fluturimeve AIA bëri gjashtë fluturime nga Tirana në Kigali gjatë fundit të vitit 2002 dhe fillimit të vitit 2003, me armët dhe municionet që atëherë iu dorëzuan grupeve rebele që luftonin në Kongon Lindore. Pohohet se aeroplanët u ngarkuan në kuadër të masave të një sigurie të lartë në një zone ushtarake të Aeroportit të Tiranës.⁴⁵⁵ Përsëri, zyrtarët Shqiptarë përgënjeshtroan që ata kishin njohuri që dërgesat do të devijoheshin në ndonjë vend tjetër, duke besuar se kishin të bënin me një kontratë të tipit qeveri me qeveri. Një deklaratë e ngjashme shfaqet edhe në raportin e Amnesty International të botuar në Korrik 2005:

Sipas studimit më të fundit, nga Prilli 2004, konflikti në Republikën Demokratike të Kongos (RDK) ka shkaktuar jetën e afërsisht katër million njerëzve. [...] Në këtë kontekst, Amnesty International është veçanërisht e shqetësuar për sa i përket dërgesave në shkallë të gjerë të armëve në këtë rajon. Ruanda importoi miliona copë municione të armëve të vogla, të granata hedhësve nga stoqet e tepërta në Shqipëri [...] Në vijim të nënshkrimit të marrëveshjes së paqes në DRC në gjysmën e dytë të vitit 2002, një seri fluturimesh me armë u kryen nga Tirana, Shqipëri për në Kigali. Fluturimet kanë vazhduar të paktën deri në Qershor 2003. Qeveria e Ruandës ka përgënjeshtroar marrjen e furnizimeve me armë nga ana e këtyre fluturimeve, por bazuar në faktet e para nga Amnesty International dhe të raporteve nga zyrtarë të qeverive në Europë, këto dërgesa ndër-kontinentale kanë pasur ngarkesë me deri në 400 tonë municione, dhe kanë përfshirë kompani nga Shqipëria, Izraeli, Ruanda, Afrika e Jugut dhe Mbretëria e Bashkuar (UK).⁴⁵⁶

Gjatë vitit 2005, Shqipëria ka qenë fokusi i akuzave për transferimin e paligjshëm apo të padëshirueshëm të armëve.

Një gazetar investigues Shqiptar informoi gjithashtu ekipin e kërkimit mbi këtë çështje për trasferta të fshehta të pajisjeve ushtarake për në Ruandë gjatë vitit 2002 dhe 2004.⁴⁵⁷ I intervistuari ishte në zotërim të dokumentave që jepnin detajet e planeve të fluturimit për dy dërgesat me ngarkesa 'sekrete' me destinacion Ruandën dhe pohoi se për këtë dërgesë të fshehtë kishin pasur ndihmesën e një ish-zyrtari të MEICO-s që punonte në seksionin e ngarkesave në Aeroportin e Rinasit. Investigimi i kësaj çështjeje u mbyll pasi gazetari nuk iu sigurua asnjë mbështetje apo mbrojtje nga punëdhënësi i tij. Në një tjetër investigim, që edhe ky nuk u çua deri në fund, gazetari pohoi se zyrtarë të nivelit të lartë në Forcat Detare të Shqipërisë kishin kryer një marrëveshje në 2001 me një ndërmjetës armësh me kombësi Greke për shitjen e silurave detare shqiptare. Sipas të intervistuarit, ndërmjetësi Grek ishte një ortak i njohur i ish-Kryeministrit Peruan, Vladimiro Montesinos, i cili doli para gjyqit në vitin 2004 për rolin e tij që shiste armë guerrilasve Kolombianë. Është interesante të evidentosh faktin që i intervistuari deklaroi se kur këto deklarata ishin publikuar, Ministria e Mbrojtjes nuk i përgënjeshtroi ato menjëherë, por njoftoi që do të kryhej një investigim i brendshëm për këtë çështje. Nga ana tjetër, asnjë rezultat i investigimit të këtyre deklaratave nuk është njoftuar ndonjëherë.

Ka pasur gjithashtu deklarata të gazetave të bëra ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë në Tiranë dhe në Forcat e Armatosura të Shqipërisë në lidhje me marrëveshje të fshehta të shitjes së armëve. Për shembull, ka pasur akuza që autoritetet shqiptare kanë lejuar eksporte të pajisjeve ushtarake për Libanin. Në një artikull të botuar në gazetën

⁴⁵⁴ Swain J dhe B Johnson-Thomas, "Terror në Kongo nga aeroplanë të bazuar në Britani", Sunday Times, 3 Korrik 2005, faqe 27. Shih gjithashtu: Amnesty International, Jetë të shkatëruara: Çështje për një Kontroll të Rreptë të Kontrollit Ndërkombëtar të Armëve (2005), faqe 10 dhe 62.

⁴⁵⁵ Po aty

⁴⁵⁶ Amnesty International, 'Republika Demokratike e Kongos: armatosja e lindjes', AFR 62/006/2005, gjendet në <http://web.amnesty.org/library/index/engaf620062005>

⁴⁵⁷ Intervistë, gazetar investigues, 21 Korrik 2005.

Republika të Tiranës në Prill 2002, pohohet që një ndërmarrje e quajtur MEICO është përdorur për vite të tëra për shitjen e një numri të madh pistoletash dhe automatikësh Kallashnikov për Libanin.⁴⁵⁸ Ky artikull deklaronte se ndërmarrja “njihet për lidhjet e saj me liderët kryesorë të shtetit Shqiptar dhe me disa qarqe të niveleve po aq të larta edhe në Liban”, dhe është përdorur për të dërguar pajisje që janë deklaruar “të humbura” ose “të vjedhura” gjatë ngjarjeve të vitit 1997. Ndërsa nuk ka qenë e mundur të konfirmohen të gjitha informacionet e dhëna në këtë artikull, ai reflekton me shqetësimin e shprehur nga vëzhguesit ndërkombëtarë të vendosur në Tiranë.⁴⁵⁹

Ish-Ministria e Rendit Publik ka qenë gjithashtu një target i deklarimeve për trafik të armëve. Sipas një raporti, Zyrtarë të lartë të Qeverisë dhe/ ose të Ministrisë së Rendit Publik kanë përdorur Repartin Nr. 100, një repart i vartësisë së kësaj Ministrie i vendosur pak larg Tiranës për të trafikuar me një vlerë disa milionë dollarësh amerikanë pistoleta, automatikë Kallashnikov, pushkë snajpere me precision të lartë, dhe pajisje të tjera jashtë Shqipërisë nga fundi i viteve 90.⁴⁶⁰ Në vitin 1999, rojet e kufirit në pikën e kalimit të kufirit të njohur me emrin Han i Hotit, zbuluan pistoleta që po trafikoheshin jashtë Shqipërisë, numri i serial i të cilave deklarohet se i përkisnin Repartit Nr. 100. Komandanti i këtij reparti spjegoi se këto pistoleta ishin ‘grabitur’ gjatë ngjarjeve të vitit 1997, një spjegim që kënaqi investiguesit shqiptarë. Megjithatë, një investigim i kryer nga një ekip Amerikan konkludoi se në depot dhe magazinat Repartit Ushtarak ka një mungesë AVL-sh që vlerësohet me rreth nëntë milionë dollarë Amerikanë. Në korrik 2001, është raportua se 14 kolonelë dhe majorë të Repartit 100 u thirrën nga zyra e prokurorit ushtarak për tu përgjigjur akuzave për trafik armësh.⁴⁶¹

Duhet të bëhet e qartë se akuzat e mësipërme nuk janë shoqëruar gjithmonë me konfirmime të tyre me fakte thelbësore. Përgënjeshtimet e këtyre deklaratave nga ana e Qeverisë Shqiptare janë, nga ana e tyre, të karakterizuara nga deklarime të përgjithshme dhe nga mungesë të informacionit faktik.

5.1.1.6 Transparenca dhe raportimi

Përveç raportit të detajuar dhe konfidencial të veprimtarive të saj që ndërmarrja MEICO duhet ti dërgojë Presidentit, Kryeministrit, Zyrës së Kontrollit të Shtetit, dhe Ministrit të Mbrojtjes në date 15 të çdo muaji, MEICO duhet të dërgojë gjithashtu një raport të detajuar mbi dërgesat e importeve dhe eksporteve çdo tre muaj për Presidentin, Kryeministrin, Shërbimet Informative, Ministrinë së Punëve të Jashtme, Ministrinë së Mbrojtjes, si dhe Zyrës së Kontrollit të Shtetit.⁴⁶² Megjithëse Komisioni të Sigurisë së Parlamentit nuk i dërgohet një kopje e këtij raporti tremuajor, Komisioni i mëparshëm të Mbrojtjes- jo më ekzistues, merrte raporte dy here në vit nga MEICO mbi transferimet që ishin kryer gjatë gjashtë muajve të fundit.⁴⁶³ Megjithatë, Komisioni i kontrollit Parlamentar mund të kërkojë të shikojë të gjitha dokumentat për importet dhe eksportet në çdo kohë, dhe mund t’i kërkojë gjithashtu Ministrit të Mbrojtjes të raportojë ai vetë para Komisionit.⁴⁶⁴ Sidoqoftë, një numër personash komentues kanë vlerësuar që Komisionet Parlamentare të Shqipërisë nuk janë vënë në dijeni të plotë për të shqyrtuar Politikën e Qeverisë.⁴⁶⁵ Sipas David Greenwood, ata duhet të veprojnë

⁴⁵⁸ Koka A, ‘Shpërthen Skandali: Armët e ushtrisë Shqiptare shiten në Lindjen e mesme’, Gazeta Republika, Tiranë [Shqipëri], 10 Prill 2002, faqe. 3. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005.

⁴⁵⁹ Intervista, zyrtarë nga organizma ndërkombëtarë, Tiranë.

⁴⁶⁰ Feci Z dhe A Hoxhaj, ‘Skandal në Ministrinë e Rendit Publik’, Republika, Tiranë, në shqip, 20 Korrik 2001, faqe. 3. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005.

⁴⁶¹ Feci Z, ‘Skandali kap investiguesit ushtarakë’, Republika, Tiranë, në shqip, 26 Korrik 2001, faqe. 3. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005.

⁴⁶² Intervistë, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.

⁴⁶³ Intervistë, deputet i parlamentit, 3 Maj 2005. Në Janar 2005, Komisioni i Mbrojtjes i Parlamentit Shqiptar u bashkua me Komisionet të tjerë duke formuar Komisionin e Sigurisë, i cili mbulon aktivitetet e Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimeve Inteligjente të Shtetit. Kjo ishte pjesë e reduktimit të Komisioneve Parlamentare nga 14 në 7. Komisioni i Sigurisë mblidhet dy herë në javë.

⁴⁶⁴ Po aty.

⁴⁶⁵ Citohet Bumçi, faqe 115–6; citohet Greenood; citohet Kajsu, faqe 108–17; Nazarko M, ‘Kontrolli demokratik dhe Civil i Forcave të Armatosura’ në Qeverisjen e sektorit të Mbrojtjes dhe të Sigurisë në Europën Juglindore: Mendime dhe Perspektivat – Shqipëria, botime të J Trapans dhe P H Fluri (DCAF, 2003) faqe 27–44; citohet Totzani, faqe 58–71.

pak më shumë se ‘pulla gome’ për politikën e Qeverisë.⁴⁶⁶

Po ashtu, shumë komentues Shqiptarë kanë deklaruar se ka pak interes nga shoqëria civile për çështjet e mbrojtjes në përgjithësi. Sipas mendimit të Aldo Bumçit dhe Blendi Kajsit, kjo ndodh sepse skena e OJQ-ve në Shqipëri bazohet vetëm mbi donatorët, dhe se ka pak donatorë që mbështesin projektet në fushën e mbrojtjes. Megjithatë, të dhënat e sondazheve të opinionit publik të mbledhura për këtë projekt gjatë vitit 2005 treguan që shumica e Shqiptarëve që morrën pjesë në të, nuk do të deshnin që armët e tepërta të Shqipërisë t’u shiteshin shteteve me regjime repressive, që janë në konflikt ose atyre të varfëra. Megjithatë, 8 përqind e të pyeturve shprehën mendimin se do të deshën që armët e vogla dhe armatimet e lehta shqiptare të shiteshin vëndeve në konflikt, dhe vetëm pak mbi 7 përqind u shprehën se nuk shihnin ndonjë të keqe për shitjen e armëve të tepërta shqiptare për vendet më të varfëra të botës (shih shtojcën). Po ashtu, megjithë nivelin e lartë të mos aprovimit të shitjes së armëve për regjimet repressive dhe për vendet e zonave në konflikt, nuk ka rezultuar asnjë protestë popullore apo aktivitet i veçantë reagues kur Shqipëria ka qenë e dyshuar për përfshirje në marrëveshje të tilla armësh. Një gazetar investigues na ka informuar se nuk ja vlen të eksplorosh rastet e dyshuara të diversionit apo të dërgesave të fshehta nga Qeveria Shqiptare, sepse nuk ka ndonjë interes publik të ndjeshëm si dhe ka një mungesë të mbështetjes publike nga media për qartësimin e lajmeve të tilla.⁴⁶⁷

Shqipëria nuk prodhon një raport vjetor mbi transfertat e armëve dhe asnjë nga të intervistuarit nuk foli për plane për fillimin e prodhimit të një dokumenti të tillë. Sidoqoftë, Drejtori i MEICO-s deklaroi se MEICO është e aftë dhe do të dëshironte të prodhonte një raport të tillë bazuar në formatin e raportit vjetor të Mbretërisë së Bashkuar mbi transfertat e armëve – nëse kjo gjë do ti kërkohej. Për momentin, nuk ka kërkesa ligjore në ligjin Shqiptar për transfertat e armëve që ato të publikohen me synim për të tërhequr vëmendjen e publikut. Po ashtu, Ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë ka lëshuar një Urdhër për MEICO-n për të përpiluar dhe publikuar një raport mbi të gjitha transfertat e armëve të Shqipërisë që janë bërë në vitet nga 1992 deri në 2004. Raporti përmban kontratat e plota tregëtare për importet dhe eksportet gjatë kësaj periudhe, dhe iu dërgua në vitin 2004 Presidentit, Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Shtetit, Shërbimit Informativ të Shtetit, disa ministrive, një numri deputetësh të Kuvendit, dhe disa ambasadave në Tiranë.⁴⁶⁸ Ky publikim nuk kishte synim për t’ju shpërndarë publikut të gjerë, dhe si i tillë, nuk duhet të konsiderohet si një dokument i rëndësishëm për përmirësimin e mbikqyrjes publike mbi transfertat mbi Armët e Vogla dhe të Lehta. Sidoqoftë, megjithë shpërndarjen e kufizuar të tij, një nga shqetësimet kryesore për Drejtorin e MEICO-s është se ky dokument ka shkelur klauzolat e konfidencialitetit të një numri të kontratave të bëra. Megjithatë, publikimi i tij dhe shpërndarja e kufizuar demonstronjë që autoritetet shqiptare e kanë kanë kapacitetin që të prodhojnë një raport i cili detajon tippet dhe sasitë e eksporteve të armëve dhe destinacionet e tyre.

Shqipëria raporton mbi çështjet e AVL-ve tek organizmat e Kombeve të Bashkuara si UNDDA-në mbi zbatimin e UNPoA mbi armët e mësipërme, tek Regjistri i Kombeve të Bashkuara të Armëve Konvencionale, si dhe tek shkëmbimi i informacionit të këtyre armëve të OSBE-së.⁴⁶⁹ Po ashtu, ka një pikë kontakti kombëtare në lidhje me çështjet e AVL-ve, e cila është vendosur në Ministrinë e Mbrojtjes.⁴⁷⁰ Shqipëria ka aplikuar gjithashtu për të aderuar në Marrëveshjen Wassenaar, megjithëse disa zyrtarë nuk janë të sigurtë nëse Shqipëria i plotëson aktualisht kriteret për anëtarësim.⁴⁷¹ Shqipëria e ka

⁴⁶⁶ Citohet Greenwood.

⁴⁶⁷ Intervistë, Anon, gazetari investigues, 21 Korrik 2005.

⁴⁶⁸ Intervistë, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.

⁴⁶⁹ Shqipëria është gjithashtu një antare e Traktatit mbi Mospërhapjen e Armëve Kimike, Biologjike dhe Bërthamore. Intervistë, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 Prill 2005. Shqipëria po përgatitet gjithashtu me një aplikim për Grupin e Australisë, dhe është ftuar në seminare në Bullgari dhe Hungari në përgatitje për antarësimin e saj. Intervistë, zyrtar i Ministrisë së Punëve të Jashtme, 25 Prill 2005.

⁴⁷⁰ Në kohën e shkrimit të këtij raporti dy persona janë listuar si pika kontakti në Ministrinë e Mbrojtjes, Nikon OSI dhe Z. Asllani. Shih <http://www.seesac.org/resources/nationalfp.htm>

⁴⁷¹ Intervistë, zyrtari i Ministrisë së Punëve të Jashtme, 25 Prill 2005.

rreshtuar veten në mbështetje të Kodit të Sjelljes së Bashkimit Europian mbi eksportet e armëve,⁴⁷² si dhe me pozicione të tjera të Bashkimit Europian në lidhje me çështjet në fjalë, por akoma nuk është ftuar të marrë pjesë në ndonjë nga mbledhjet e COARM-it.

5.1.2 Ministria e Rendit Publik/ Ministria e Brendshme

Seksioni në vijim analizon rolin që ka pasur deri pak kohë më parë Ministria e Rendit Publik (MRP). Kur raporti është shkruar dhe në vijim të Zgjedhjeve të Përgjithshme të vitit 2005, Ministria e Rendit Publik është zëvendësuar nga një Ministri e re e Brendshme. (MB). Në terma të përgjithshëm, Ministria e re e Brendshme ka të gjitha funksionet e Ministrisë së Rendit Publik si dhe përgjegjësi të tjera, përfshi edhe qeverisjen locale dhe regjistrimin e popullsisë.

Në kohën e përpilimit të këtij raporti, ndryshimet e planifikuara në strukturën e Ministrisë së Brendshme akoma nuk janë zbatuar plotësisht dhe si e tillë, autorët besojnë se ky seksion të jetë i saktë për kohën aktuale. Megjithatë, parashikohet që mund të ketë ndryshime në sferën e veprimtimit të punës që kryejnë disa departamente dhe drejtori brenda Ministrisë si dhe ndryshime të mundshme në personelin e saj. Megjithë këtë, është parashikuar që funksionet themelore të Ministrisë në lidhje me liçencimin e armëve, grumbullimin, anti-trafikimin dhe zbatimin e ligjit do të jenë ashtu siç janë shpjeguar në menyrë të detajuar më poshtë.

Përveç se me përgjegjësi për të menaxhuar stoqet e veta të armëve, Ministria ka gjithashtu përgjegjësi për monitorimin dhe menaxhimin e zotërimit civil të armëve të zjarrit të regjistruara në Shqipëri, si dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikun e armëve.

5.1.2.1 Menaxhimi i stoqeve të Ministrisë së Brendshme

Mbajtja e dokumentacionit

Ministria e Brendshme ka një sektor të veçantë që merret me monitorimin e depove të AVL-ve në forcat e policisë dhe në ministritë e tjera.⁴⁷³ Të gjitha detajet e depove të policisë janë hedhur në një bazë kompjuterike të dhënash dhe janë gjithashtu të dubluara me mbajtje të dokumentacionit manual. Informacioni që futet në këto dy sisteme përfshin: numrin serial të armës, kalibrin dhe modelin, dhe detaje mbi oficerin e policisë për të cilin ajo është regjistruar, përfshi adresën e tyre dhe numrin e telefonit. Megjithatë, sistemi i kompjuterizuar funksionon vetëm në nivel qendror, dhe si tillë, komisariatet e prefekturave dhe rajonet e policisë lokale nuk kanë akses direkt në këtë sistem. Kjo do të thotë që sistemi të dhënave i kopjuterizuar i nivelit qendror mund të jetë disa muaj mbrapa informacionit në terren, për shkak të largësisë kohore midis dhënies së armëve oficerëve të rinj, çarmatimin e atyre personave që largohen nga policia, dhe raportimit të këtyre të dhënave autoriteteve qendrore. Kjo është një fushë e qartë që duhet të korrigohet, për të siguruar dokumentim të saktë dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit midis niveleve qendrore, rajonale dhe atyre lokale.

Siguria

Sipas mendimit të shefit të armatimit të Ministrisë së Brendshme, siguria e magazinave për AVL-të në magazinat e armëve dhe në shumicën e rajoneve të policisë është e mire.⁴⁷⁴ Oficerë të policisë nga drejtoria e inspektimit bëjnë kontrolle në rajonet e policisë në nivele të ndryshme mbi sigurinë e magazinimit të tyre, duke u siguruar gjithashtu që dokumentimet e mbajtura në qendër korrespondojnë me gjendjen në fakt në nivel lokal. Shefi i armatimit të Ministrisë së Brendshme deklaroi me mirëbesim se ai nuk kishte dijeni për vjedhje armësh të kohëve të fundit nga magazinat e nivelit lokal. Kjo deklaratë u shoqërua me kontrolle të bazuara në të dhënat e këtij

⁴⁷² Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.604, "Mbi miratimin e përgjithshëm të Kodit të Sjelljes së BE për eksportet e armëve", 28 Gusht 2003.

⁴⁷³ Intervistë, zyrtari i Ministrisë së Rendit Publik, 26 Prill 2005.

⁴⁷⁴ Intervistë, Zyrtar i Ministrisë së Rendit Publik, 26 Prill 2005.

raporti: në Fier, ne ishim informuar që nuk kishte pasur kohët e fundit vjedhje të ndjeshme në magazinat e policisë, megjithëse 45 armë janë raportuar ‘të humbura’ midis 1997 dhe 2003.⁴⁷⁵ Shefi i Armatimit të Ministrisë së Brendshme na informoi se kishte pasur dy incidente të raportuara të humbjes së armëve të policëve gjatë vitit të kaluar. Në Tiranë, një officer policie e la pistoletën e tij brënda komisariatit të policisë dhe një pistoletë tjetër kishte humbur kur një officer policie ishte përfshirë në një aksident rrugor në Shkodër. Ishhin marrë masa për të gjetur këto piateleta dhe autoritetet janë tani duke hetuar për t’i ndëshkuar apo jo këta oficerë.

Megjithëse oficerët e policisë mund ti mbajnë në shtëpi me vete armët e tyre personale të brezit, pushkët e tyre luftarake duhet të dorëzohen në magazine kur ata mbarojnë detyrën e shërbimit. Po ashtu, sipas fakteve konkretë, që prej vitit 1997 oficerët e policisë ndjehen tashmë më të përgjegjshëm për armët e tyre.⁴⁷⁶ Ata marrin instruksione se si të kujdesen për armët e tyre si dhe kanë bërë më shumë trajnime për magazinimin, ruajtjen dhe përdorimin më të sigurtë në krahasim me periudhën e para vitit 1997.

5.1.2.2 Procesi i liçencimit të armëve të zjarrit për civilët

Me përjashtim të një kategorie të vogël civilash (p.sh. që përfshin disa biznesmenë, banorë të kufirit, shoferët e Deputetëve) civilët mund të lejohen të mbajnë vetëm armë gjahu sipas legjislacionit aktual mbi mbajtjen e armëve. Për mbajtjen e një arme në mënyrë të ligjshme në Shqipëri, një qytetar duhet të bëjë një kërkesë zyrtare në rajonin e policisë lokale, duke paraqitur edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Një certifikatë që përmban të dhënat personale;
- Një raport mjekësor që vërteton gjëndjen e mire shëndetsore të aplikantit;
- Një deklaratë nga një doktor i çertifikuar që vërteton se ju nuk jeni i çmendur;
- Një certifikatë që vërteton që ju nuk jeni përfshirë në asnjë çështje kriminale, e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet një gjykate lokale;
- Një certifikatë që vërteton që ju nuk jeni aktualisht nën hetim për një padi kriminale, e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet një gjykate lokale;
- Një certifikatë që deklaron se ju nuk i detyroheni ndonjerit të holla, e cila lëshohet nga një përmbaues gjyqësor;
- Për shumë civilë, edhe një certifikatë nga një organizatë gjuetie lokale;
- Një deklaratë e departamentit të policisë lokale që deklaron se jeni një “qytetar i mirë” dhe që mund të lejoheni të merrni një liçencë (ky dokument supozohet që garanton se ju nuk jeni i përfshirë në gjakësi, grindje me fqinjët tuaj, etj.).⁴⁷⁷

Po ashtu, më poshtë po japim taksat për licencat e armëve të ndryshme:

- Për një pistoletë: 600 lekë;
- Për një pushkë automatike: 6000 lekë;
- Për një pushkë gjahu: 1000 lekë.⁴⁷⁸

Aplikimi vlerësohet më pas nga një komision, i cili ka në përbërje shefin e komisariatit të policisë, (që është edhe shef i këtij komisioni), shefin e zbatimit të ligjit dhe shefat e departamenteve të krimeve. Zyrtarë të tjerë që kanë lidhje me rastin në fjalë mund të ftohen të marrin pjesë në komision në vartësi nga tipi i liçencës që është duke u vlerësuar. P.sh. në Fier, kur biznesmenët kërkojnë licence për pistoletë, merr pjesë në komisionin e vlerësimit edhe Drejtori i Policisë së rajonit.⁴⁷⁹

⁴⁷⁵ Intervistë, Zyrtar i Ministrisë së Rendit Publik, 16 Maj 2005.

⁴⁷⁶ Intervistë, Zyrtar i Ministrisë së Rendit Publik, 26 Prill 2005.

⁴⁷⁷ Kjo listë e plotë bazohet në një numër intervistash me oficerë policie të Ministrisë së Rendit, në të cilën përmenden një seri e listave të dokumentave të ndryshëm. Intervistat, Caushaj, 16 Maj 2005; Zyrtar i MRP, 14 Qershor 2005; Zyrtar i MRP, 14 Maj 2005; Zyrtar i MRP, 25 Prill 2005.

⁴⁷⁸ Intervistë, zyrtar i MRP, 25 Prill 2005.

⁴⁷⁹ Intervista, zyrtar i MRP, 16 Maj 2005; zyrtar i MRP, 14 Maj 2005.

Procesi i vlerësimit zgjat afërsisht 30 ditë. Liçencat nuk lëshohen për një periudhë të veçantë, megjithatë ato mund të anulohen në çdo kohë nga ana e policisë. Nëse aplikimi për një licence pranohet, atëherë jepet autorizim për aplikantin për të blerë një armë gjahu nga një dyqan gjahu i regjistruar.⁴⁸⁰ Një armë mund të blihet edhe jashtë Shqipërisë, dhe në këtë rast arma duhet të regjistrohet në pikën e kufirit të hyrjes për në Shqipëri. Pavarësisht se arma është blerë brenda apo jashtë Shqipërisë, ajo duhet të regjistrohet në rajonin e policisë lokale.

Sipas Ilirjan Zaimit, Shef i Sektorit të Policimit në Komunitet dhe të Grumbullimit të Armëve, policia ka përgjegjësi të sigurojë që armët e regjistruara të gjahut janë të magazinuara në mënyrë të sigurtë në mjedisin e shtëpisë, megjithëse ata nuk kanë autoritet të revokojnë liçencat apo të sekuestrojnë armët nëse ato nuk janë magazinuar në mënyrë të sigurtë.⁴⁸¹ Një ekip i veçantë inspektorësh i kryejnë këto kontrolle, bazuar në listen e të gjithë armë mbajtësve të regjistruar. Ata duhet të sigurojnë që të gjitha tytat e pushkëve të gjahut të jenë të bllokuara jashtë periudhës së sezonit të gjahut (dmth nga 28 Shkurti–31 Gusht). Është raportuar që viti 2005 do të jetë viti i parë që do të kryhen kontrolle të tilla në të gjithë Shqipërinë. Nëse një armë gjëndet e 'pa bllokuar' jashtë periudhës së sezonit të gjuetisë, atëherë ajo duhet të raportohet në rajonin e policisë lokale së bashku me arsyen e gjëndjes së saj të pabllokuar.

Sipas një vëzhgimi të brendshëm të kryer nga ISO për këtë raport në vitin 2005, 77.3 përqind e pjesëmarrësve në anketim besonin se liçencat e armëve ishin të nevojshme, megjithëse më shumë se gjysma e tyre nuk ishin në gjëndje të pohonin nëse ata mendonin se liçencat e mbajtjes së armëve ishin të shtrenjta apo të vështira për tu marrë. Por, kishte gjithashtu edhe ndryshime të ndjeshme në pikpamje rajonale për sa i përket një numri pyetjesh. Për shëmbull, 14 përqind e pjesëmarrësve në veri janë plotësisht dakord me deklarinë që 'liçencat e armëve nuk janë të nevojshme', ndërsa vetëm 1 përqind e pjesëmarrësve në qendër të vendit janë plotësisht dakord me këtë deklarinë. Tabela më poshtë tregon masën në përqindje që numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve të anketuar nga i gjithë vendi janë ose nuk janë dakord me deklarinë e ndryshme:

Tabela 26: Në çfarë mase ju jeni dakord apo nuk jeni dakord me deklarinë e mëposhtme?

	Liçencat e armëve nuk janë të nevojshme	Liçencat e armëve janë shumë të shtrenjta	Liçencat e armëve është e vështirë të merren
Plotësisht dakord	7.6%	10.8%	16.2%
Përgjithsisht dakord	3.8%	8.3%	8.2%
As dakord as kundër	1.7%	5.3%	5.5%
Përgjithësisht jo dakord	4.1%	6.0%	6.1%
Aspak dakord	77.3%	10.5%	9.2%
Nuk e di	5.2%	56.8%	51.9%
Nuk dhanë përgjigje	0.3%	2.3%	3.0%
Totali	100%	100%	100%

5.1.2.3 Drejtoria e Luftës kundër Krimin të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve⁴⁸²

Sipas raportit të ish-Ministrisë së Rendit Publik për veprimtarinë e saj në vitin 2004 dhe para ri-organizimit të Ministrisë pas zgjedhjeve të vitit 2005, Drejtoria e Luftës kundër Krimin të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve ishte përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e të gjitha aktiviteteve të policisë në luftën kundër krimin të organizuar, përfshi këtu edhe aktivitetet e trafikimit. Drejtoria ka 6

⁴⁸⁰ Në Shkodër ka dy dyqane armësh, dhe ato shesin vetëm pushkë gjahu.

⁴⁸¹ Intervistë, zyrtar i MRP, 25 Prill 2005.

⁴⁸² Informacioni i këtij seksioni është marrë nga: Intervistë, zyrtar i MRP, 20 Prill 2005; cit MRP, faqe. 62.

sektorë: lufta kundër trafikut të drogës; lufta kundër i trafikëve të tjera të paligjshme, të armëve, njerëzve, objekteve të artit dhe makinat; pastrimin e parave dhe krimin financiar; mbrojtjen e dëshmitarit; operacionet speciale – një njësi mbështetëse; si dhe analiza e organizatave kriminale.

Po ashtu, çdo rajon policie në të 12 Prefekturat e Shqipërisë ka nga një Drejtori të Krimin të Organizuar, megjithëse ato nuk kanë secilën prej përgjegjësive të të gjithë seksioneve të rreshtuara më sipër. Pa dyshim, që është ende herët të flasësh për një Drejtori që nuk e ka mbushur akoma një vit pune, megjithatë duket se perspektiva e saj është e mirë, sepse ajo parashikohet të asistojë për bërjen e legjislacionit të ri të fushës, për kryerjen e një analize të plotë të aktivitetit të krimin të organizuar dhe grupet e tij në Shqipëri, për rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të policisë nëpërmjet trajnimeve me metodat investigative speciale, dhe për punën për përmirësimin bashkëpunimin ndër-institucional dhe ndërkombëtar, si dhe për shkëmbimin e informacionit.

Sipas mendimit të Drejtorit të Drejtorisë së Luftës kundër Krimin të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, këto synime shtrojnë një numër sfidash⁴⁸³ përfshi këtu për shëmbull çështjen e bashkëpunimit midis agjencive e ndër-institucional brënda vendit, e cila kërkon zhvillime të mëtejshme. Në veçanti, ka shumë vend për përmirësim të mëtejshme në marrëdhëniet e punës bashkëpunuese midis Drejtorisë dhe Shërbimit Informativ Kombëtar, Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorisë së Doganave, si dhe me homologët e tyre të vëndeve të tjera dhe në trajnimin mbi teknikat moderne të luftës kundër krimin të organizuar.

Drejtorja vetëm kohët e fundit ka filluar të analizojë të dhënat mbi grupet e krimin të organizuar në Shqipëri. Kjo analizë rezultoi se disa grupe duken se i kanë fokusuar aktivitetin e tyre të trafikëve mbi tipe unike të ‘komoditetit’; kryesisht të trafikëve të qënieve njerëzore dhe të drogës. Mendohet se ka gjithashtu grupe në Shqipërinë veriore, kryesisht përgjatë kufirit me Malin e Zi, për të cilët trafiku i armëve është biznesi i tyre kryesor. Grupe të tjera, variojnë në trafike të armëve apo automjeteve të vjedhura, në vartësi të rastit të paraqitur të komoditetit të ndryshëm të trafikut në kohë të ndryshme.

5.1.2.4 Sektori i Luftës kundër Trafikut të Paligjshëm⁴⁸⁴

Sektori i Luftës kundër Trafikut të Paligjshëm është vendosur në vartësi të Drejtorisë së Luftës kundër Krimin të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, dhe përqendron aktivitetin e saj në përmirësimin e metodave për luftën kundër krimin të organizuar dhe trafiket e qënieve njerëzore, të drogës, AVL-ve, automjeteve të vjedhura dhe veprave të artit. Siç u tha edhe më parë, lufta kundër trafikëve të qënieve njerëzore dhe drogave është vlerësuar si një shqetësim i madh kohët e fundit. Prandaj, puna e fillimit të këtij sektori është fokusuar në përpilimin e strategjisë dhe planeve të punës për të luftuar trafiket në këto fusha. Në të njëjtën kohë, sektori parashikohet të arrijë synimet e Drejtorisë nëpërmjet trajnimit, përmirësimin të kapaciteteve organizative dhe operacionale të policisë në sferën e anti-trafikut dhe forcimit të bashkëpunimit me agjencitë e tjera brënda Shqipërisë dhe shteteve fqinje. Në mënyrë të veçantë, pritet që të forcohet bashkëpunimi me Zyrën e Krimeve të Renda të Prokurorisë dhe me Task Forcën për kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta në lidhje me çështjet që janë nën investigim. Për sa i përket njësive dhe sektorëve dhe departamenteve të tjerë, theksohet si sfida dhe proritete kryesore asistencë për trajnim dhe pajisja e atyre që janë të angazhuar në luftën kundër trafikëve.

5.1.2.5 Drejtorja Qendrore e Policisë Kufitare dhe e Migracionit⁴⁸⁵

Qëllimi i deklaruar i Drejtorisë së Përgjithshme të është përmirësimi i efektivitetit të

⁴⁸³ Intervistë, zyrtar i MRP, 20 Prill 2005.

⁴⁸⁴ Informacioni i këtij seksioni është marrë nga: Intervistë, zyrtar i MRP, 20 Prill 2005; cit MRP, faqe 68–71.

⁴⁸⁵ Informacioni i këtij seksioni është marrë nga: Intervistë, zyrtar i MRP, 25 Prill 2005; cit MRP, faqe.77–8.

menaxhimit të kufirit dhe trajtimi i trafikeve të paligjshme. Për të arritur këtë qëllim Policia Kufitare është jo vetëm e pranishme në çdo pikë të kalimit të kufirit, por gjithashtu ndërmer patrullime të lëvizshme të pjesëve të kufijve të Shqipërisë që nuk kanë infrastrukura të instaluar të kontrollit statik. Ata po punojnë aktualisht me zyrtarë të PAMECA-s për të vlerësuar zbatimin e strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufijve të Shqipërisë, sigurinë e kufijve detarë dhe plane të ndryshëm trajnimesh.

Sipas Shefit të Sektorit për Shërbimet Kufitare, çdo pikë e kalimit të kufirit ka libra dhe manuale të printuar që përmbajnë informacion mbi Armët e Vogla dhe Armatimet e Lehta, pajisjet ushtarake dhe mallrat me përdorim të dyfishtë që janë subjekt i kontrolleve të eksportit dhe importit. Megjithëse oficerët e doganave janë kryesisht përgjegjës për kontrollin e dërgesave në kufijtë e Shqipërisë, policia kufitare e Shqipërisë ka gjithashtu të drejtën ligjore të kryejë kontrolle të dërgesave me pajisje ushtarake dhe ato me përdorim të dyfishtë.⁴⁸⁶ Megjithatë, inspektimet e shërbimeve kufitare zakonisht kryhen në bashkëpunim me oficerët e doganës. Në rastet kur oficerët e doganës kryejnë një kontroll të dërgesës pa prezencën e një oficeri të policisë kufitare, deklarohet që ata normalisht duhet t'ja dërgojnë informacionin e tyre edhe policisë kufitare.⁴⁸⁷ Praktika e kryerjes së kontrolleve dhe e punës në bashkëpunim me anëtarët e shërbimit të doganave në çdo pikë të kalimit kufitar është relativisht e re, e zhvilluar si pjesë e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufijve të Shqipërisë.

Sipas një raporti, policia kufitare ka aktualisht një personel prej 1,682 vetë, me 80 përqind të tij të trajnuar sipas raportimeve nga ekspertët ndërkombëtarë të CAM-A, ICITAP, INTERFORZA, PAMECA dhe misionëve të tjera ndërkombëtare.⁴⁸⁸ Megjithatë, densiteti i raportuar për kilometër të kufirit i policisë kufitare është më poshtë se nivelet e rekomanduara të Bashkimit Europian. Per shëmbull, një praktikë e mirë në menaxhimin e integruar të kufijve rekomandon një mesatare prej dy deri në tre police kufitare për çdo kilometre të kufirit. Nivelet e kufijve Shqiptarë janë treguar në tabelën e mëposhtme.⁴⁸⁹

Tabela 27: Numri i policëve kufitarë për çdo km

Kufiri me	Malin e Zi	Kosovën	Maqedoninë	Greqinë
Policë kufitarë për çdo km	0.86	1.85	1.26	1.41

Megjithë vënien në dispozicion të automjeteve dhe të trajnimeve nga organizmat ndërkombëtarë, dhe të planeve për të zhvilluar një strategji për një kontroll më të mire të kufijve tokësorë të Shqipërisë, policia kufitare e Shqipërisë akoma përballet me një sfidë në rritje në kufizimin e volumit të trafikut të peregjistruar që kalojnë midis shtigjeve malore dhe rajoneve të kufirit të pambuluar me personel të kufirit.⁴⁹⁰ Për shëmbull, ndërsa një raport argumenton që "gjithmonë do të jetë e vështirë të mbahet nën kontroll terreni i vështirë i zonave të thella malore" të pjesës veriore të Shqipërisë,⁴⁹¹ një tjetër raport deklaroi se pjesa e kufirit jugor përmban shtigje që vetëm njihen nga banorët lokale të cilët mund të shtojnë të ardhurat e tyre duke plotësuar me trafike ose duke shitur informacione mbi këto shtigje trafikantëve.⁴⁹² Në të dyja raportet, është pohuar trafikimi i armëve nëpërmjet përdorimit të shtigjeve të ndryshme.

Megjithatë, sipas këshilltarëve ndërkombëtarë që punojnë për përmirësimin e shërbimeve kufitare të Shqipërisë, sektori i shërbimit kufitar që përballet me sfidat më

⁴⁸⁶ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 27 Prill 2005.

⁴⁸⁷ Për shëmbull, në Aeroportin e Rinasit ka vetëm oficerë të doganave që merren me inspektimet e dërgesave, sepse rojet e policisë së kufirit janë aktualisht përgjegjës kryesisht për ruajtjen e perimetrit të aeroportit dhe kontrollin e pasaportave.

⁴⁸⁸ Citohet Bumçi, Ymeri dhe Dakli, faqe 30.

⁴⁸⁹ Po aty, faqe 29.

⁴⁹⁰ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005.

⁴⁹¹ Citohet Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 2004, faqe 13.

⁴⁹² 'Raporti detajon rritje të qarkullimit të Armëve të Paligjshme në Greqi', FBIS-EEU-2001-0419, Athinë To Vima, në Greqisht, 19 Prill 01 faqe A15 [Teksti i përkthyer nga FBIS]. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005.

të mëdha është ai që ka të bëjë me patrullimin e kufijve detarë të Shqipërisë.⁴⁹³ Sipas mendimit të këtyre këshilltarëve ndërkombëtarë, ekziston një shqetësim i mungesës së personelit të trajnuar dhe të pajisjeve përkatëse për të kryer me sukses detyrat e shërbimeve të kufirit detar. Për shëmbull, sipas raprtimeve shumë anije patrullimi nuk janë në gjëndje të mire pune dhe ka shqetësime që policia nuk është në gjëndje të paguajë shpenzimet e karburantit që lidhet me përdorimin e tyre. Mangësitë e kësaj natyre janë duke u vlerësuar tani në kuadrin e një projekti të sponsorizuar nga BE me emrin ‘Përcaktimi i sistemit të menaxhimit të kufirit të kaltër të Shqipërisë’, me propozime për përmirësime që priten së shpejti.⁴⁹⁴

Ka nga ata në policinë kufitare të Shqipërisë që mendojnë se meqë menaxhimi i kufijve është një prioritet i Bashkimit Europian, ai nuk trajtohet me seriozitet të veçantë në Shqipëri aktualisht.⁴⁹⁵ Ka argumenta se ndërsa ka retorikë nga autoritetet Shqiptare mbi rëndësinë e tij, këtij problemi nuk po i kushtohet i njëjti vullnet politik. Ky është ndoshta një shpjegim i pjesshëm, për faktin që Ministria e Mëparshme e Rendit Publik kishte marrë për vitin 2004 vetëm një pjesë të fondeve të kërkuara për implementimin e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufijve të Shqipërisë.⁴⁹⁶ Për shembull, ndërsa një numër i synuar për blerje të pajisjeve ka qenë deklaruar, mbetet për tu parë nëse Qeveria Shqiptare do të mbulojë me fondet e nevojshme mangësitë e vlerësuar në pajisjet e kërkuara që jepen në tabelën e mëposhtme.⁴⁹⁷ Përveç pajisjeve të përfshira në këtë tabelë, përfaqësuesit e shërbimeve të kufirit dhe të doganave mendojnë se Shqipërisë i nevojiten më shumë pajisje të teknologjisë së lartë për zbulim, si psh, skanera të lëvizshëm për përdorim në rritjen e efektivitetit të kontroleve të kufirit.⁴⁹⁸

Tabela 28: Resurset teknike të policisë kufitare të Shqipërisë ndaj niveleve të dëshirueshme

Pajisjet	Automjete	Anije	Radarë	Qen Kufiri	Dylbi	Pajisje të shikimit natën
Në copë gjatë 2004	41	18	28	27	33	3
Sasia e dëshirueshme	113	32	79	81	182	84

Problemi i korrupsionit është pranuar nga autoritetet shqiptare dhe ka pasur një numër rastesh në policisë kufitare për elementë që janë shkarkuar për shkak të praktikave korruptive në vitet e fundit. Megjithë këtë veprim pozitiv, korrupsioni vazhdon të vlerësohet si një problem serioz për imazhin e policisë kufitare.⁴⁹⁹ Me një shqetësim të veçantë janë policia kufitare që punojnë në Durrës dhe Vlorë, si dhe në aeroportin e Rinasit. Shqetësimet kryesore në këto porte janë ato që policia kufitare ka pranuar pagesa të caktuara në shpërblim të lejimit nga ajo të dokumentave të udhëtimit të fallsifikuar.

Ka argumentime që megjithëse oficerët e policisë transferohen në mënyrë të shpeshtë në poste të të ndryshme të policisë, praktikat korruptive vazhdojnë të konsiderohen si ‘një përfitim i llojit të punës’ dhe si të tilla janë falur, duke i lëvizur oficerët në sektorë të tjerë policie, në vend që të shkarkohen apo të ndiqen penalisht nëse ata gjendet fajtorë për akte korruptive.⁵⁰⁰ Duke e përzierë problemin, fakti që oficerët e policisë transferohen brenda dhe jashtë policisë së kufirit në seksionet e tjera të policisë konsiderohet i dëmshëm për sa i përket përpjekjeve të anti trafikimit, sepse kjo gjithashtu do të thotë që oficerët e policisë të trajnuar për të marrë përsipër detyra të policisë kufitare mund të transferohen për shëmbull në policinë e trafikut ose në policinë e komunitetit, “duke shpërdoruar” në këtë mënyrë trajnimin e tyre, një

⁴⁹³ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar 28 Prill 2005.

⁴⁹⁴ Ky projekt është në zbatim nga ICMPD (Qendra Ndërkombëtare për Migracionin dhe Zhvillimin e Policisë), një OJQ që është e vendosur në Austri.

⁴⁹⁵ Koment i bërë gjatë një workshopi mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve. Intervistë 28 Prill 2005

⁴⁹⁶ Citohet Bumçi, Ymeri dhe Dakli, faqe 31.

⁴⁹⁷ Po aty, faqe 30.

⁴⁹⁸ Intervista, zyrtar i Doganës, 4 Maj 2005; zyrtar i MRP, 25 Prill 2005.

⁴⁹⁹ Citohet MRP, faqe 106.

⁵⁰⁰ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005.

shqetësim ky i ngritur nga një numër i të intervistuarve shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Si një ilustrim të këtij problemi, duket se ka vend të thuhet se si pasojë e humbjes së personelit të aftë, edhe pajisjet e teknologjisë së lartë qëndrojnë jashtë funksionimit në disa raste, sepse oficerët e trajnuar për përdorimin e këtyre pajisjeve janë transferuar, dhe asnjë oficer tjetër në një pike të caktuar të kalimit kufitar nuk ka pasur trajnimin e nevojshëm për këtë.⁵⁰¹ Sidoqoftë nëse oficerët do të transferoheshin thjesht nga një pikë kalimi kufitar në një tjetër, dhe jo në detyra krejtësisht të ndryshme, atëherë trajnimi i tyre dhe aftësitë e fituara nuk do të shkonin dëm. Po ashtu, do të argumentohej që transferime të tilla do të përdroreshin si një mjet kundër korrupsionit dhe do të siguronin që trafikantët të mos bëheshin të aftë të vendosnin një ‘marrëdhënie’ me oficerë të veçantë të policisë kufitare.

5.1.3 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave⁵⁰²

Qeveria parashikon që deri në vitin 2007 legjislacioni i doganave të Shqipërisë do të jetë në përputhje me të gjitha standardet e Bashkimit Europian. Strukturat operacionale dhe procedurat aktualisht në funksionim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë në pjesën më të madhe të tyre në përputhje me standardet e BE-së, falë kryesisht asistencës të dhënë nga Misioni i Asistencës së Doganave të Komisionit Europian – Albania (CAM-A), e cila ka qenë në Shqipëri qysh prej vitit 1997.⁵⁰³

Drejtorja e Doganave ka tre drejtori:

- Drejtoria e informacionit, me seksionin operativ dhe atë të analizës së rreziqeve;
- Drejtoria e investigimit;
- Drejtoria e Anti-kontrabandës për kufijtë tokësorë, kufijtë detarë dhe njësia anti-trafik.

Po ashtu, ka edhe një sektor për kontrollin e dërgesave në rajonet që nuk janë të klasifikuara si rajone kufitare.

Informacioni mbi çdo dërgesë të AVL-ve hidhet me dorë në librat e regjistrimit (regjistrat) në pikat e kalimit të kufirit, kështu që për shëmbull, dërgesat e armëve dhe municioneve duhet të regjistrohen me detajet e markimit, tipet e armëve dhe të pajisjeve dhe të volumit të regjistruar në librat që mbahen në magazine dhe të arkivuar. Ka gjithsej pesë pika të kalimit të kufirit ku ka aktualisht një bazë të kompjuterizuar të dhënash funksionale, megjithatë parashikohet që përfundimisht të gjitha 25 pikat e kalimit të kufirit do të vendosen on-line, ku të dhënat mbi çdo dërgesë do të futen direkt në një bazë kompjuterike të dhënash dhe do t'i dërgohen direkt një serveri qendror. Shërbimet e doganave kanë zbatuar deri tani rreth 80 përqind të Sistemit të Kompjuterizuar të Menaxhimit të të dhënave të Doganave (ASYCUDA++) për të ndihmuar në kryerjen e vlerësimit të rrezikut të deklarimit dhe të komunikimit midis niveleve locale dhe atyre kombëtarë. Ky sistem ndihmon në identifikimin e dërgesave të cilave duhet tu kushtohet një rishikim i mëtejshëm i dokumentave ose të kryhen inspektime fizike. Ata janë duke ngarkuar tani të dhënat në bazën e të dhënave duke i marrë të dhënat nga dokumentet e vjetra në hard-copy dhe duke instaluar software-in e profilit të rrezikut dhe profilet e tyre, të cilat ata besojnë se do t'i ndihmojë ata të arrijnë gjykime më të mira se kur duhet të kryejnë kontrolle fizike. Në vitin 2004, rreth 6 përqind e të gjitha dërgesave të kargos (përfshi në disa raste edhe dërgesat në tranzit) iu nënshtruan kontrolleve fizike, përjashtuar kontrollet e kryera në pikat e kalimit kufitar për trafikun e pasagjerëve. Nuk është e qartë nëse të gjitha dërgesat e armëve dhe municioneve që janë bërë mbi baza ligjore janë midis dërgesave të kontrolluara.

Vëzhguesit ndërkombëtarë janë të mendimit se ka një stabilitet relativ, përmirësim të profesionalizmit, dhe më shumë institucionalizim në Drejtorinë e Doganave se më parë.⁵⁰⁴ Në fakt, janë të mendimi që procedurat në Drejtorinë e Doganave janë më

⁵⁰¹ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 27 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005.

⁵⁰² Informacioni në këtë seksion është marrë nga: Intervistë, zyrtar i Doganave, 4 Maj 2005.

⁵⁰³ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 27 Prill 2005.

⁵⁰⁴ Intervistë, zyrtar i doganave, 4 Maj 2005.

shumë të institucionalizuara se në institucionet e tjera të shtetit, ku patronazhi dhe besnikëria politike konsiderohet se akoma përbën një problem.⁵⁰⁵ Një nga faktorët që ka ndihmuar në sjelljen e këtyre ndryshimeve është pa dyshim fakti që oficerët e doganave paguhën më mirë se kolegët e tyre në policinë e shtetit dhe në sektorët e tjerë shtetërorë. Këshilltarët ndërkombëtarë, si psh CAM-A (shih më poshtë), kanë pohuar se ata kanë mbështetur dhe inkurajuar shumë për futjen e masave të pagesës të bazuara mbi performancën si një nga mjetet kryesore për të luftuar korrupsionin. Kjo do të thotë që oficerët e doganave marrin tani një pagesë që ju siguron një standard të mirë jetese duke evituar tentativat e marrjes së rryshfeteve. Kjo është dhe një nga arsytet që shërbimet e doganave duken tani të arrijnë të tërheqin personel me cilësi më të larta, dhe problemet e korrupsionit janë ndjeshëm në ulje – krahasuar me agjencitë e tjera të shtetit.

Një masë tjetër që është adoptuar për të luftuar korrupsionin në shërbimin e doganave është edhe rotacioni i stafit të doganave ndërmjet pikave të ndryshme të kalimit të kufirit. Kjo masë është adoptuar me qëllimin që oficerët e doganave të mos jenë aq të prekshëm për rastet e ofertave të korrupsionit. Kjo ka gjithashtu avantazhin që shërbimi i doganave është në vartësi direkte nga autoritetet qendrore në Tiranë dhe jo të drejtorëve rajonalë që janë shpesh me qëndrime dhe sjellje të ndryshme ndaj korrupsionit. Siç u tha më sipër, kjo është pare si një problem i veçantë për policinë e kufirit, ku rotacionet nënkuptojnë transferimin e oficerëve të policisë nga policia e kufirit ndoshta në një sektor tjetër të policisë ku aftësitë dhe eksperiencia e tyre është në shumë raste jo e mirë.

Një nga fushat me theks të veçantë në intervistat në lidhje me rëndësinë e konsiderueshme të luftës kundër trafikëve nga shërbimet e doganave të Shqipërisë, është dhe vënia në punë e skanerave për bagazhet personale dhe për dërgesat e kargove. Në aeroportin e Rinasit ata përdorin një skaner për të ndihmuar në zbulimin e eksplozivëve, armëve dhe pajisjeve luftarake. Në portin e Durrësit, përdoren gjithashtu skanera për bagazhet personale dhe shpresohet që gjatë vitit 2005, të merren edhe dy skanera të lëvizshëm të instaluar për inspektimin e dërgesave të kargove, përfshi edhe kontejnerët. Kjo blerje do të mbështetet me fondet e Qeverisë Shqiptare, me synimin e përmirësimit të kontrollit dhe inspektimit të dërgesave, përfshi edhe rritjen e shpejtësisë së kontrolleve. Janë identifikuar edhe dy pika doganore me Malin e Zi që kanë nevojë për skanera, dhe besojmë që të gjitha pikat e kalimit të Kufirit në Kukës kanë nevojë për skanera, së bashku me ndonjë pike të veçantë përgjatë kufirit me Greqinë. Parashikohet që brenda një periudhe afatshkurtër deri afatmesme, skanerat e lëvizshëm do të vihen në funksionim. Tani për tani, shumë nga kontrollet e dërgesave në pikat e kalimit të kufirit kryhen me përdorimin e endoskopëve dhe pasqyrave.

5.1.4 Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)

Drejtoria e Integritimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) ka përgjegjësi me gjetjen e kanaleve dhe përcjelljen e informacionit për në dhe nga organizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë (përfshi BE-në, OKB-në dhe OSBE-në) dhe me shtete të tjera, si dhe me ato ministri në Shqipëri që përgjigjen direkt për çështjen e AVL-ve. Prandaj, për shëmbull, informacioni për Dokumentin e vitit 2001 mbi AVL-të të OSBE-së dërgohet nga MEICO dhe Ministria e Mbrojtjes për në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe më pas dërgohet nga jo e fundit për në OSBE.⁵⁰⁶ Ministria e Punëve të Jashtme rifreskon gjithashtu listat e pajisjeve ushtarake dhe mallrat me përdorim të dyfishtë nga Bashkimi Europian dhe Marrëveshja Wassenaar për Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe shtetet nën embargo nga Bashkimi Europian dhe Kombet e Bashkuara.⁵⁰⁷ Në fakt, Ministria e Jashtme shërben si një organizëm i tipit 'zyre qendrore' për shkëmbimin e informacionit mbi AVL-të dhe për pajisjet ushtarake, me

⁵⁰⁵ Po aty.

⁵⁰⁶ Intervistë, MFA official, 25 Prill 2005.

⁵⁰⁷ Ibid.

përpunimin e informacionit dhe zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare që bien nën përgjegjësinë zyrtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ministria e Punëve të Jashtme ka përgjegjësinë e përfaqësimit të Shqipërisë në vendimarrjet dhe diskutimet ndërkombëtare në çështje që lidhen me AVL-të. Për shembull, përfaqësuesit e MPJ nga Tirana së bashku dhe Misioni i OKB-së përbënë delegacionin në Takimin Dytëor të Kombeve të Bashkuara në vitin 2005 për të marrë në konsideratë zbatimin e Programit të Veprimit të OKB-së mbi AVL-të. Megjithatë, në nivelin operacional jo domosdoshmërisht veprohet në të njëjtin mënyrë, si për shembull Ministria e Brendshme vepron si një Ministri kryesore në Task Forcën SECI-it (Inisiativa e bashkëpunimit e Europës Juglindore). për AVL-të

Parashikohet që roli që luan Ministria e Punëve të Jashtme në lidhje me transfertën e armëve do të ndryshojë nëse legjislacioni i ri i planifikuar miratohet dhe hyn në fuqi. Nëse kjo ndodh, atëherë Ministria e Punëve të Jashtme do të përfshihet direkt në procesin e liçencimit të eksporteve në vend të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila luan aktualisht rolin drejtues në këtë çështje.

5.1.5 Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe roli i OJQ-ve

Gjatë viteve të fundit ka pasur një përfshirje të gjerë të OJQ-ve lokale dhe të shoqërisë civile në projektet e kontrollit të Armëve të Vogla dhe Armatimeve të Lehta në Shqipëri. Kjo përfshirje ka ndodhur së pari nëpërmjet projekteve të UNDP-it (Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara), duke filluar me përdorimin e OJQ-ve lokale dhe përfaqësuesve të komunitetit (siç përmendet më sipër) në Projektin Pilot të Gramshit (PPG) dhe duke vazhduar me Armët në Këmbim të Zhvillimit (AKZH), projektet e AVL-ve dhe ai i MRSE.

Gjatë Projektit të PPG u vendos një rrjet i organizmave jo qeveritarë (OJQ). Ky rrjet vazhdoi të punojë me projektet e UNDP gjatë projektit AKZH, dhe disa anëtarë vazhduan veprimtari të ngjashme edhe me PKAVL-ve. PKAVL punësoi disa OJQ për të asistuar në përcjelljen e mesazheve të rritjes së ndërgjegjësimit të projektit, duke siguruar një kanal shtesë në shpërndarjen e informacionit për projektin. OJQ-të punuan mbi baza vullnetare ose kontraktuale duke prodhuar materiale, organizuar evenimente dhe zbatuar projektet e zhvillimit.⁵⁰⁸

Megjithë kontributin e tyre të dobishëm në projekte specifike, shoqëria civile dhe veçanërisht grupet e OJQ-ve e kanë pasur të vështirë ti mbështesnin aktivitetet e tyre jashtë projektit specifik që ata ishin sponsorizuar për të marrë pjesë. Kjo më shumë për faktin se shumë OJQ që janë aktivizuar në aktivitete e kontrollit të AVL-ve mbështeten plotësisht në fondet që ata marrin për përfshirjen e tyre në projekt. Kjo jep pak hapësirë për gjenerimin e aktiviteteve lokale dhe siguron që në një masë të konsiderueshme komuniteti i OJQ-ve të jetë plotësisht në dorë të donatorëve, gjë që bën shumë të vështirë që OJQ-të të tërheqin fonde për aktivitetet e veta të tyre. Kjo ka çuar në disa raste në një shtrëmbërim të mundshëm të disa tipeve të aktiviteteve që janë organizuar nga OJQ-të; sipas një përfaqësuesi, shumica e aktiviteteve të shoqërisë civile të ndërmarra në këtë fushë kanë qenë drejtuar drejt komunitetit të donatorëve dhe OJQ-ve, sesa ndaj atyre njerëzve që tentojnë të përdorin AVL-të për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ose tentojnë ti shesin ato.⁵⁰⁹

Megjithëse UNDP nuk mbështet më rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi grumbullimin e AVL-ve, ajo mbetet përsëri një sponsor i rëndësishëm dhe mbështetës i aktiviteteve të OJQ-ve që lidhen me kontrollin e AVL-ve. Kështu, si pjesë e projektit aktual MRSE të UNDP në Shqipëri, në shkollë po kryhet një punë educative mbi sigurinë dhe paqen. Për shembull, prej 15 Majit deri në 15 Korrik 2003, Lëvizja për Çarmatim dhe Safer-Albania organizuan një projekt pilot me emrin 'Edukimi mbi Çarmatimin dhe Kultura Paqësore', duke dhënë leksione dhe mësimë që trajtonin

⁵⁰⁸ SALWCP 2002–2003 page, <www.undp.org.al>, accessed 02 February 2005.

⁵⁰⁹ Intervistë, përfaqësuesi i OJQ, 21 Korrik 2005.

çështje që përfshinin rrezikun e trafikut të drogës, të qënieve njerëzore, të AVL-ve, të prostitucionit, në dy shkolla në Shkodër dhe dy në Tiranë. Disa nga leksionet mbi AVL-të u dhanë nga oficerë policie, me metoda të reja mësimore, diskutimeve në grup, dhe me përdorimin e medias elektronike, duke ju siguruar informacion rreth 2200 mësuesve dhe studentëve të përfshirë në këtë projekt pilot.⁵¹⁰ Mbi këtë experience, është krijuar një model i efektshëm, në mënyrë për ta shtrirë projektin më tej.⁵¹¹

Punë tjetër po bëhet nëpër shkolla nga Qendra e Edukimit për Paqen dhe Çarmatimin në Shqipëri, mbi armët e vogla dhe çështje të çarmatimit mbi bazën e një kuadri më të gjerë të edukimit për paqen. Kjo punë fokusohet në zhvillimin e ndërgjegjësimit e studentëve më të vjetër për problematikat nëpërmjet debateve dhe përpunimit të politikave publike 'alternative', si dhe rritjen e ndërtimit të kapacitetit të mësuesve për ndërmarrjen e aktiviteteve të edukimit mbi paqen në një afat më të largët.⁵¹² Në bashkëpunim me Institutin për Studime Pedagogjike ata kanë trajnuar 8 mësues në Gramsh dhe Shkodër, të cilët u certifikuan si trajnues kombëtarë në edukimin për paqen gjatë vitit 2004. Këta mësues kanë marrë pjesë në shumë aktivitete si ëorkshope mbi edukimin për paqen gjatë dy viteve të fundit dhe kanë përpiluar edhe aktivitetet e edukimit të paqes për manualin e mësuesve me emrin "Drejt një kulture të paqes"; një kapitull i të cilit është përfshirë në Manualin Kombëtar për Mësuesit e shkollave 9 vjeçare.

Një OJQ shqiptare shfrytëzon ekspertizën e një oficeri të armatim-municioneve në pension për të asistuar në një numër shërbimesh që kanë lidhje me demilitarizimin, përfshi këtu edhe trajnimin dhe AMA-në. Qendra Kombëtare e Çmilitarizimit (QKÇ) u themelua si një OJQ në Janar 2003, dhe ka rreth 250 antarë anëmbanë Shqipërisë. Antarët e QKÇ -së janë ish ushtarakë, në veçanti ish xhenjerë ushtarakë, dhe ata janë kryesisht në Berat, Elbasan, Gjirokaster, Korçë, Kukës, Shkodër dhe Tiranë.⁵¹³ Në vitin 2003, ata shpërthyen 352 tonë municione për një projekt të sponsorizuar nga SHBA me një kosto prej 157 US\$ për çdo ton. Qysh prej vitit 2003, ata kanë kontribuar në Projektin e Demilitarizimit të Municioneve të AVL-ve të NAMSA-s së NATO-s duke vënë në dispozicion shërbime të verifikimit, trajnimin e shoferëve për transportim në rajonet e demilitarizimit, kryerjen e inspektimeve të rajoneve të demilitarizimit, si dhe ri-paketimin e 900 tonë municioneve.

Media në Shqipëri luan një rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit. Analiza e mbulimit nga media për këtë vëzhgim ka treguar se çështjet që lidhen me AVL-të kanë gjetur një mbulim të konsiderueshëm nga mediat. Por, në shumicën e rasteve ky mbulim mediatic fokusohet mbi skandalin dhe interesin njerëzor sesa mbi investigimin e rasteve të veçanta në një mënyrë të detajuar dhe uniforme. Aktualisht ka sfida të rëndësishme për mënyrën sesi mediat i trajtojnë armët dhe çështjet që lidhen me sigurinë, dhe del e qartë se trajnimi për drejtuesit e medias dhe pronarët e tyre është po aq i rëndësishëm sa dhe ai i gazetarëve, sepse ka shumë raste që mbulimi nga media udhëhiqet nga motive politike sesa nga raportime objektive të çështjeve në fjalë.

5.1.6 Bashkëpunimi ndërinstitucional (midis agjencive)

Qeveria e mëparshme mori disa hapa për përmirësimin e koordinimit duke punuar në bashkëpunim me SEESAC-un e bazuar në Beograd për zhvillimin e një strategjie mbi kontrollin e AVL-ve. Ky dokument, i cili përmban seksione mbi rritjen e ndërgjegjësimit dhe grumbullimin dhe shkatërrimin e tyre si një prioritet, parashikon gjithashtu edhe krijimin e një Komisioni të Armëve të Vogla dhe Armatimeve të Lehta dhe të një Plani kombëtar Veprimi.⁵¹⁴ Drafti i strategjisë nuk u miratua nga Parlamenti para zgjedhjeve të Korrikut 2005 dhe nuk duket se përbën një prioritet edhe për

⁵¹⁰ Lëvizja për Çarmatim dhe Safer-Albania, Raport përfundimtar mbi zbatimin e projektit 'Edukimi mbi Çarmatimin dhe Kulturën e Paqes (DEPC)', (Tiranë, Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, Mbështetje për Reformën në Sektrin e Sigurisë, Korrik 2003).

⁵¹¹ Intervistë, përfaqësues i OJQ, 21 Korrik 2005.

⁵¹² Intervistë, përfaqësues i OJQ, 8 February 2005.

⁵¹³ Intervistë, përfaqësues i OJQ, 25 Prill 2005.

⁵¹⁴ Intervistë, zyrtar i MRP, 15 Prill 2005.

qeverinë e re. Megjithatë, është e rëndësishme që një dokument i tillë të përgatitet nga të gjitha Ministrinë e linjës dhe të institucioneve të tjera të interesuara për të shërbyer si një udhëzues për trajtimin e sfidave që po përballet Shqipëria në lidhje me AVL-të. Parashikohet që ky dokument Vëzhgimor të shërbejë si një element i vlefshëm i menaxhimit të informacionit në zhvillimin e një strategjie të tillë kombëtare, autorët e të cilit besojnë se kjo strategji duhet të zhvillohet dhe të zbatohet nën drejtimin e një komisioni kombëtar të AVL-ve.

Sfidat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërministerial dhe ndërinstucional kanë të bëjnë me ndryshimin në shumë raste midis atyre që shkruhen në rregulloret përkatëse të ndryshme dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave, dhe nga ana tjetër e realitetit konkret, të cilat shpesh në praktikë lënë shumë për tu dëshiruar. Në shumë raste, duket se kjo mungesë koordinimi është pjesërisht një pasojë e lëvizjeve të shpeshta të personelit në shumë departamente kryesore që janë përgjegjës për sigurinë dhe për kontrollin e armëve të vogla. Shumë persona të stafit nuk qëndrojnë në detyrën e caktuar për një kohë të gjatë, gjë që përbën një sfidë për zhvillimin e marrëdhënieve të mira të punës me kolegët e tyre të departamenteve dhe Ministrive të tjera. Kjo gjithashtu shkakton probleme për sa i përket zhvillimit të kapaciteteve institucionale, fitimit të njohurive historike dhe krijimit të lidhjeve efektive me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.⁵¹⁵ Më poshtë janë paraqitur tre raste studimore për sa i përket fushës së veprimit të AVL-ve, për të treguar disa nga ndryshimet që vihen re në praktikë midis rregulloreve dhe gjëndjes faktike të zbatimit të bashkëpunimit ndërinstucional. Rasti i parë i përket një propozimi për rritjen e komponentit ndërinstucional të sistemit të kontrollit të import-eksporteve. Rasti i dytë jep disa komente të përgjithshme mbi zbatimin në Shqipëri të menaxhimit të integruar të kufijve. Rasti i tretë diskuton mbi procedurat e grumbullimit të armëve në Shqipëri.

5.1.6.1 Sistemi i kontrollit të transfertave

Për momentin, shumica e vendimeve që i përkasin import-eksporteve të Shqipërisë për Armët e Vogla dhe të Lehta dhe pajisjet ushtarake merren në Ministrinë e Mbrojtjes. Vetëm MEICO ka të drejtën e aplikimit për një licencë për importin apo eksportin e një dërgese me pajisje ushtarake, me AVL si dhe/ose me municione. Megjithëse Ministria e Mbrojtjes, sipas raportimeve, konsultohet me Ministrinë e Jashtme në lidhje me statusin e gjëndjes së embargos ndërkombëtare për shtetin destinator ose për rrezikun e diversionit (devijimit të ngarkesës) ose kërcënimit të sigurisë kombëtare apo ndërkombëtare, shikohet se ka shumë pak bashkëpunim ndërinstucional në lidhje me transfertat e armëve. Sipas Drejtorit të MEICO-s, një nga avantazhet e këtij sistemi është se vendimet mbi aplikimet mund të merren shpejt, megjithëse ai gjithashtu ankohet që mangësitë në bashkëpunimin ndër-institucional do të thotë që transfertat e MEICO-s mund të nënshtrohen vonesave të gjata në pikat doganore.⁵¹⁶

Kjo situatë mund të ndryshojë nëse propozimet e bëra për ngritjen e një komiteti ndër-ministerial për import-eksportet vihen në zbatim. Është propozuar që një komitet i tillë të kryesohet nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe do të ketë përgjegjësi kryesore për marrjen e vendimeve mbi aplikimet e licencave.⁵¹⁷ Komiteti do të përbëhet nga përfaqësues nga agjenci (institucione) të ndryshme të shtetit, si Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve të interesuara të shtetit. Ka gjithashtu një dëshirë që komiteti ndërministror të mbledhet mbi baza të rregullta, megjithëse nuk është e qartë akoma nëse do të ketë kushte ligjore për mbledhje të rregullta. Sidoqoftë, nga

⁵¹⁵ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 12 Prill 2005.

⁵¹⁶ Drejtori i MEICO-s shprehu se këto vonesa kanë ndodhur se MEICO nuk mund të jepte rrushfete zyrtarëve të doganës për të përsheptuar procesin – diçka që ai mendon se kanë mundësi dhe e bëjnë firmat private. Intervistë, Zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005.

⁵¹⁷ Sipas një zyrtari të MPJ, ky ndryshim ishte propozuar nga zyrtarë amerikanë. Intervistë, zyrtar i MPJ, 25 Prill 2005.

shumë mendohet se do të ishte më me vend që të lëvizet kontrolli i import-eksporteve nga Ministria e Mbrojtjes, pasi kjo do të sillte Shqipërinë në linjë të njëjtë me mekanizmat e shteteve të tjera dhe do të rriste përputhjen me normat dhe standardet e Bashkimit Europian.⁵¹⁸

Një numër i caktuar problemesh janë parashikuar me ndryshimet strukturore të propozuara në sistemin e kontrollit të import-eksporteve të Shqipërisë. Për shëmbull, zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme informuan ekipin kërkimor që kjo Ministri ka për momentin vetëm një ekip të vogël që shqyrton dhe këshillon mbi aplikimet e licencave.⁵¹⁹ Organi i mbikqyrjes së transfertave duhet pra të bëjë trajnime speciale për tu bërë plotësisht operacional, si dhe mund të nevojitet mbështetje me staf nga Ministria e Mbrojtjes për Ministrinë e Jashtme. Vëzhgues ndërkombëtarë janë të mendimit që Ministria e Punëve të Jashtme mund të jetë me staf shumë të pakët për të kryer detyrat e mbikqyrjes së import-eksporteve.⁵²⁰ Eshhtë e nevojshme vazhdimi i asistencës ndërkombëtare për të ndihmuar në kontrollin dhe monitorimin e end-userave, në kryerjen e kontroleve para dhe pas dërgesës. Një nga rreziqet është që komiteti ndërministerial, megjithëse mund të krijojë përshtypje të rëndësishme në letër për donatorët ndërkombëtarë, mund të mos rezultojë domosdoshmërisht për të përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional në terren, prandaj ai mund të bëjë pak për parandalimin e diversioneve/devijimeve të armëve në duart e end-userave të paligjshëm.

5.1.6.2 Menaxhimi i Integruar i Kufijve⁵²¹

Ka pasur një numër Memorandumesh Mirëkuptimi të llojit ndërministror apo ndërinstitucional të nënshkruara në lidhje me bashkëpunimin mbi anti-trafikimin dhe menaxhimin e kufijve. Për shëmbull, sipas një të intervistuarit, Memorandume Mirëkuptimi janë nënshkruar midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shqiptar, agjencive të bujqësisë, biznesit, dhe organizmave të tjera që kanë të bëjnë me doganat.⁵²² Ndoshta shëmbulli më i spikatur dhe vizionar është Strategjia mbi Kontrollin e Kufijve dhe Menaxhimin e Integruar të tyre, e cila u miratua nga Këshilli i Ministrave në Shkurt 2003 dhe për zbatim në vitet nga 2003 në 2006. Dy synimet kryesore të kësaj strategjie janë:

- Të përmirësojë bashkëpunimin midis agjencive të ndryshme në Shqipëri – p.sh. doganat, policia kufitare, shërbimet informative;
- Të përmirësojë bashkëpunimin me fqinjët dhe me shtetet e Bashkimit Europian.

Për të arritur këto synime, Autoritetet shqiptare duhet të përmirësonin legjislationin, dhe të reformonin strukturat organizative, trajnimin e personelit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse. Kështu, në vitin 2003 policia e kufirit dhe oficerët e doganave filluan të zhvillojnë konceptin e task forcave të përbashkëta për luftën kundër trafikëve, dhe tani janë duke diskutuar një organizëm të përbashkët të pikave të kalimit të kufirit të Shqipërisë me policinë e kufirit. Ka shumë shpresa se kjo do të përmirësojë:

- Kontrollin – duke rritur përdorimin e kapaciteteve inteligjente të çdo shërbimi;
- Verifikimet – duke siguruar një punë të përbashkët më të ngushtë;
- Efiçencën – duke siguruar shpërndarjen dhe përdorimin e përbashkët të resurseve në secilën pikë të kalimit të kufirit për blerjen e pajisjeve, në vend të blerjes së pajisjeve për çdo shërbim të veçantë.

⁵¹⁸ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 29 Prill 2005; Zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 Prill 2005.

⁵¹⁹ Intervistë, zyrtar i MPJ, 25 Prill 2005.

⁵²⁰ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 29 Prill 2005.

⁵²¹ Ky seksion bazohet në intervistat me: zyrtar ndërkombëtar, 27 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005.

⁵²² Intervistë, zyrtar i doganave, 4 Maj 2005.

Qysh prej pranverës 2005, policia e kufirit dhe doganat janë duke punuar me PAMECA dhe CAM-A duke bërë një vlerësim të progresit të tyre. Ka pasur disa vlerësime krejt të mira pozitive për përpjekjet në të cilat oficerët e doganave dhe të policisë së kufirit kanë punuar së bashku. Për shëmbull, një eksperiment i kohëve të fundit në portin e Durrësit është vlerësuar nga zyrtarët e CAM-A si një model i përshtatshëm për tu eksperimentuar edhe në pikat e tjera të kufirit të Shqipërisë. Sipas mendimit të tyre, bashkëpunimi ndër-institucional është përmirësuar ndjeshëm në këtë pike të kalimit të kufirit, duke pasur fillimisht një rezistencë për ndryshimin e rregullave të punës, e cila u tejkalua shpejt. Megjithatë këtë, ata theksojnë se mbetet akoma shumë për të bërë për të arritur një menaxhim të integruar të kufijve, veçanërisht në luftimin e korrupsionit në shërbimet e kufirit dhe të doganave.

Të tjerë nuk kanë të njëjtin mendim me eksperiencat pozitive dhe optimizmin e CAM-A, duke argumentuar se bashkëpunimi ndër-institucional midis policisë së kufirit dhe doganave është akoma një problem i prekshëm.⁵²³ Një grup i këshilltarëve ndërkombëtarë kanë argumentuar se iniciativa e CAM-A mbi njësi të përbashkëta të krimit të organizuar të policisë së kufirit dhe të doganave ka një prezencë të kufizuar dhe e mbështet besimin më shumë tek marrëdhëniet personale sesa ato të institucionalizuara.⁵²⁴ Ata vazhdojnë duke përmendur një numër pengesash që duhet të thyhen në mënyrë që të vendosen marrëdhënie institucionale. Kjo përfshin edhe evitimin e xhelozisë që policia kufitare ndjen për kolegët e saj në dogana. Policia kufitare e di që doganat marrin shtesa shpërblimi, pra rroga më të larta se kolegët e tyre të policisë së kufirit, megjithatë ata bëjnë shumë detyra të njëjta gjatë ditës së punës. Futja e pagesës sipas performances së punës për oficerët e doganave mund të luaj një rol të ndjeshëm në interes të luftës kundër korrupsionit dhe përmirësimit të profesionalizmit në shërbimin doganor, por duket se kjo përbën një pengesë për bashkëpunimin e ngushtë midis policisë së kufirit dhe atyre të doganave. Përgjithësisht, raportohet se oficerët e kufirit ndjehen më inferiorë ndaj kolegëve të tyre të doganave, duke shtuar këtu edhe lëvizjet e shpeshta të stafit të lartë.

Mbetet për tu parë se si do të bëhet vlerësimi drejt menaxhimit të integruar të kufijve që do të kryhet gjatë vitit 2006, por ndërsa shihen shënja të progresit pozitiv, vijat ndarëse midis personelit të këtyre agjencive të ndryshme shtetërore mbeten akoma. Këto nuk janë vetëm në lidhje me nivelet e pagesës, por janë gjithashtu të lidhura pa dyshim edhe me ndryshime strukturore që mund të kërkojnë më shumë se tre vjet të funksionojnë normalisht. Progresi drejt synimeve të menaxhimit të integruar të kufijve do të kërkojë më shumë se mbështetje më të madhe financiare, ajo do të kërkojë gjithashtu edhe mbështetje politike më të besueshme dhe të vazhdueshme.

5.1.6.3 Grumbullimi i Armëve të Vogla dhe të Lehta

Bashkëpunimi midis agjencive (institucioneve) në fushën e grumbullimit të armëve u diskutua në seksionin 6.

5.1.7 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

5.1.7.1 Bashkëpunimi Bilateral

Bazuar në raportin vjetor për vitin 2004 të ish-Ministrisë së Rendit Publik, gjatë vitit 2004 janë nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare për bashkëpunimin e policisë, si dhe të bashkëpunimit kundër krimit të organizuar me Qeverinë e Belgjikës, të Republikës Çeke, Francën, Maqedoninë, Malin e Zi, Poloninë, Sllovakinë, dhe Mbretërinë e Bashkuar. Përveç këtyre marrëveshjeve, Ministria e Brendshme ka zhvilluar marrëdhënie dhe bashkëpunuar në një numër projektesh me partneret

⁵²³ Cituar Bumçi, Ymeri dhe Dakli, faqe 31; Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar 28 Prill 2005.

⁵²⁴ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar 28 Prill 2005.

ndërkombëtarë.⁵²⁵ Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka nënshkruar 14 marrëveshje bilaterale me agjenci të doganave të shteteve të tjera në rajonin e Europës Juglindore dhe më tej.⁵²⁶

Në përgjithësi, shkëmbimi i informacionit bilateral me autoritetet qendrore dhe lokale të kufirit dhe të doganave të Greqisë, Italisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi janë vlerësuar si shumë pozitive dhe që funksionojnë mirë.⁵²⁷ Për shëmbull, në 2004, Shërbimi i doganave të Shqipërisë ka pasur 7,000 komunikime me homologët e tyre italianë dhe rreth 5,000 me atë grekë në nivel qendror. Autoritetet doganore të Shqipërisë sipas raportimeve, kanë mbajtur takime zyrtare me homologët e tyre të shteteve fqinjë dhe të Kosovës çdo tre muaj, si dhe takime të tjera shitesë nëse kërkohej një gjë e tillë. Në pikat e kalimit të kufirit bëhen takime çdo muaj që drejtohen nga shefat e doganave të secilës palë të kufirit. Këto takime janë trajtuar si raste të mira për të shkëmbyer informacion mbi tipat e mallrave që trafikohen, profilin e trafikantëve dhe informacion mbi trafikantët e dyshuar.⁵²⁸

Marrëveshje të tilla janë në fuqi edhe për shërbimet e kufirit me pika kontakti të disa niveleve të vendosura në të gjitha nivelet që nga pikat e kalimit të kufirit deri në nivelet qendrore me të gjithë fqinjët e Shqipërisë. Kështu për shëmbull, takimet midis stafeve të Shqipërisë dhe të Maqedonisë bëhen çdo dy javë në nivel lokal, me takime çdo muaj në nivel rajonal dhe çdo tre muaj në nivel qendror. Deklarohet se ka komunikime pothuaj të përditshme me telefon dhe postë elektronike midis oficerëve të policisë së kufirit të dy anëve të kufirit, të cilat depozitohen dhe arkivohen, me informacion që më pas i kalohet agjencive eprore Shqiptare nëse informacioni përbën interes për to. Arben Hanelli, Shefi i Sektorit të Shërbimit të Kufirit, theksoi gjithashtu se janë vendosur marrëdhënie të mira personale midis stafit në nivele të ndryshme. Sipas mendimit të tij, kjo është një bazë themelore për bashkëpunim dhe besim reciprok.⁵²⁹ Përveç këtij komunikimi të koordinuar dhe shkëmbimi të informacionit organizohen gjithashtu edhe patrullime të përbashkëta me bazë të rregullt të bregdetit shqiptar me rojet bregdetare greke dhe italiane, megjithëse kanë lindur në 'kufijtë e gjelbër' edhe ndonjë problem të raportuar që ka dalë nga bashkëpunimi i patrullave të kufirit.⁵³⁰

Siç u përmend edhe më sipër, Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë mban bashkëpunim informal bilateral me Qeveritë e SHBA dhe të Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, ku sipas të dhënave ajo konsultohet me stafin e ambasadave përkatëse gjatë kohës së vlerësimit të dhënies ose jo të liçencave të aplikimeve të bëra për pajisje ushtarake apo për mallra të përdorimit të dyfishtë.

5.1.7.2 Bashkëpunimi Shumëpalësh

Shqipëria raporton mbi çështje të Armëve të Vogla dhe të Lehta ndaj:

- Departamentit të OKB-së për Çështjet e Çarmatimit, në Programin e Veprimit për të Parandaluar, Luftuar dhe Çrrënjësuar Tregtinë e Paligjshme të Armëve të Vogla dhe të Lehta në të Gjitha Aspektet e Saj (UNPoA),
- Regjistrin të OKB-së të Armëve Konvencionale

⁵²⁵ This is a list of international partners that actively cooperated with the then MOPO in 2004: AEPC (Association of European Police Colleges), DCAF (Democratic Control of the Armed Forces), DEA, Europol, FBI, French Police, General Secretariat of Interpol, Greek Police, ICITAP (International Criminal Investigative Training Assistance Programme), INTERFORZE (Bilateral police mission Italy – Albania), ICMPD (International Centre for the Migration Policy Development), IOM (International Organisation for Migration), Italian Police, Macedonian Police, Montenegro Police, OSCE (Organisation for Security and Cooperation in Europe), PAMECA (Police Assistance Mission of the European community to Albania), UK Police, UNDP (United Nations Development Programme), UNHCR (United Nations High Commissioner for Refugees), UNDOC (United Nations Office on Drugs and Organised Crime), UNMIK (United Nations Mission in Kosovo), US Department of Justice (Organised Crime Desk) – Department of Justice of the USA (Organised Crime Office). Source: Ibid, p. 161.

⁵²⁶ Intervistë, zyrtari i doganave, 4 Maj 2005.

⁵²⁷ Intervistë, zyrtari i doganave, 4 Maj 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; MOPO official, 25 Prill 2005; international official 28 Prill 2005.

⁵²⁸ Intervistë, zyrtar i doganave, 4 Maj 2005.

⁵²⁹ Intervistë, MRP official, 25 Prill 2005.

⁵³⁰ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005.

- Programit të Shkëmbimit të Informacionit të OSBE-së mbi Armët e Vogla dhe të Lehta.⁵³¹

Siç përmendet më sipër në këtë raport në seksionin 5.1.6.6, Shqipëria ka identifikuar një pikë qendrore kombëtare si pjesë e angazhimit të saj në Paktin e Stabilitetit të Europës Juglindore, Plani i Implementimit Rajonal, e cila është aktualisht në Ministrinë e Mbrojtjes.

Qeveria Shqiptare e shikon bashkëpunimi multilateral për çështjet e armëve dhe të sigurisë si një element jetësor për rreshtimin e saj në institucionet Euro-Atlantike. Kjo mund të evidentohet nga interesi i saj për të aderuar në Marrëveshjen Wassenaar dhe dëshirën e saj për të demonstruar angazhimin e saj për reforma në çështje që lidhen me kontrollin e import-eksporteve nëpërmjet mbështetjes për Kodin e Sjelljes mbi Eksportin e Armëve të Bashkimit Europian. Kjo mbështetje publike për zhvillimin e një kontrolli efektiv ndaj armëve si një hap drejt Europës, është për tu përshëndetur në veçanti dhe është në disa raste reflektuar edhe me prova të sjelljes së ndryshimeve në nivel operacional. Megjithë këtë fakt, mbetet shumë për të bërë nga Qeveria Shqiptare për të realizuar zotimin e saj për bashkëpunimin multilateral në çështje të armë-kontrollit. Për shëmbull, pa arritjen e miratimit dhe më pas të zbatimit të një legjislacioni të ri në lidhje me transfertat e armëve, i cili të përfshijë rregullimin e aktiviteteve të brokerimit, prodhimin tranzit dhe të liçencuar si dhe vendosjen e një regjimi të liçencimit të bazuar mbi kritere, është shumë e vështirë të mendohet si, edhe pse me qëllimet më të mira, Qeveria mund të plotësojë zotimin e saj për zbatimin e frymës së Kodit të Sjelljes së BE-së.

Përveç bashkëpunimit të veçantë në fushën e armë-kontrollit, Shqipëria merr pjesë gjithashtu në një numër inisiativash rajonale të të anti-trafikut, të sigurisë së kufijve dhe kundër krimit të organizuar, si dhe në konventat ndërkombëtare në lidhje me tarifatat doganore.⁵³² Këto përfshijnë Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore, Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (OEBDZ),⁵³³ Inisiativa e Europës Qendrore (IEQ), Platforma e Perbashkët e Ohrit për Menaxhimin dhe Sigurinë e Kufijve, dhe Qendrën Rajonale të SECI-it për Luftën ndaj Krimit Transnacional, ku një zyrtar shqiptar drejton pikërisht task forcën që merret me AVL-të. Në këtë funksion, ky zyrtar ka zhvilluar dhe menaxhuar Operacionin 'Ploughshares' (2002–3) dhe Operacionin 'Safe Place' (2004–5), dy stërvitje të shkëmbimit të informacionit mbi kapjet e AVL-ve në Europën Juglindore.⁵³⁴

Por, megjithë këto demonstrime pozitive të progresit, ka shëmbuj, kryesisht brënda kufijve të Shqipërisë, ku bashkëpunimi multilateral në fushën e anti-trafikut ka qenë më pak i suksesshëm, përfshi këtu qendrën anti-trafik në Vlorë (tani e mbyllur). Qendra u inaugurua me ndihmën e Qeverive Gjermane, Greke dhe Italiane, por që atëherë nuk ka shfaqur një performancë në lartësinë e duhur siç ishte parashikuar. Problemet e saj përfshijnë: ankime nga çdo pjesëmarrës që të tjerët nuk janë plotësisht të angazhuar në shkëmbimin e informacionit; ankime që qendra është e shtrënguar nga një ngarkesë të madhe burokratike; ankime që qendra vuan nga mungesa e pajisjeve kryesore përfshi pajisjet e komunikimit dhe të zbulimit; dhe ndoshta problemi më serioz dhe më legjitim, fakti që Vlora nuk vlerësohet më si një rajon i rëndësishëm për trafikim, duke marrë në konsideratë faktin që ka pasur një rënie të

⁵³¹ Shqipëria është gjithashtu një antar i Traktatit të Armëve Kimike, Biologjike dhe të Traktatit të Mospërhapjes së Armëve Berthamore. Intervistë, Zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 Prill 2005. Shqipëria po përgatit gjithashtu një aplikim për Grupin e Australisë dhe ka qenë e ftuar në seminare Bullgari dhe Hungari në përgatitjet e saj për antarësim. Intervistë, zyrtar i MPJ, 25 Prill 2005.

⁵³² Intervistë, zyrtar i doganës, 4 Maj 2005.

⁵³³ Shqipëria ka nënshkruar 'Protokollin shtesë mbi Luftën kundër Terrorizmit të Marrëveshjes midis Qeverive të vendeve anëtare të Inisiativës së Bashkëpunimit Ekonomik të Vendeve të Detit të Zi, për Luftën kundër krimit, veçanërisht formave të krimit të organizuar'. Burimi: Citohet MRP, faqe 24, 48 dhe 50.

⁵³⁴ Ky workshop planifikimi për Operacionin 'Safe Place' u mbajt në Tiranë në Dhjetor 2004, dhe parapriu fillimin e kësaj stërvitje të shkëmbimit të informacionit. Burimi: 'Task Force – lufta ndaj trafikut të armëve të vogla, armatimeve të lehta dhe eksplozivëve: Projekt I, Trafikimi i Paligjshëm i armëve të vogla, armatimeve të lehta dhe eksplozivëve, Operacioni Ploughshares', Projekt dokument, Qendra Rajonale e SECI-it dhe Ministria e Rendit Publik, Tiranë, 2002.

ndjeshme në numrin e gomoneve që përdorin këtë pjesë të bregdetit për trafikimin e njerëzve përtej Adriatikut.⁵³⁵

5.2 Asistenca Ndërkombëtare

Që nga viti, Shqipëria ka përfituar nivele të konsiderueshme asistence ndërkombëtare, financiare dhe teknike në një sërë fushash që kanë të bëjnë me kontrollin e AVL-ve. Megjithatë nivelet e asistencës janë pakësuar, shuma të konsiderueshme vazhdojnë të jepen nga donatorët ndërkombëtarë për Shqipërinë. Kjo pjesë raporti fokusohet në tri nga fushat ku është siguruar asistencë ndërkombëtare për:

1. Asgjesimin e AVL dhe municioneve të tepërta dhe menaxhimin e rezervave⁵³⁶
2. Menaxhimin e kufijve dhe anti-trafikimin
3. Grumbullimin e armëve

5.2.1 Asistenca ndërkombëtare: asgjësimi i AVL-ve dhe municioneve të tepërta dhe menaxhimi i rezervave

Që prej vitit 2000, Qeveria Shqiptare dhe donatorët ndërkombëtarë kanë financuar asgjesimin e rreth 141,000 AVL në Shqipëri. Në Shtator 2000, Ministria Shqiptare e Mbrojtjes nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Qeveritë e Gjermanisë, Norvegjisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke rënë dakord për asgjesimin e 100,000 AVL-ve. Ky u pa si një shëmbull ku Shqipëria riafirmoi angazhimin e saj për të asgjesuar AVL-të e grabitura gjatë krizës së 1997, duke marrë përsipër nxitjen e asgjesimit të rezervave të tepërta të armëve dhe kontributin e saj për mbështetjen e shtyllës së sigurisë të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore.⁵³⁷ Bazuar në këtë Memorandum, Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhanë 100,000 AVL për projektet e asgjesimit të financuar nga ndërkombëtarët në 2001. Qeveria Gjermane financoi një skuadër ushtarake Gjermane për të asgjesuar 40,000 AVL në periudhën Janar–Mars 2001, me një projekt të bashkëfinancuar Amerikano-Norvegjez për asgjesimin e 60,000 AVL të tjera. Ky projekt u drejtua nga një kontraktues privat, EOD Solutions Ltd, dhe filloi në Maj 2001.

Tabela 29: Përmbledhje e asgjesimit të armatimeve dhe AVALL në Shqipëri 1997–2004

Procesi i asgjesimit	AVL	Armatime (ton)	Shënime
Projekti UNDP AKZH (2000/2002)	16,000	–	Asgjesuar nga agjenci Shqiptare
Projekti i Gjermanisë (2001/2002)	40,000	–	Asgjesuar nga Skuadra ushtarake Gjermane
Projekti Norvegji/SHBA (2001/2002)	60,000	–	EOD Solutions Limited
Asgjesimi i financuar nga Mbretëria e Bashkuar (2003/2004)	12,500	–	EOD Solutions Limited
Asgjesimi i financuar nga SHBA	12,500	–	EOD Solutions Limited – ne vazhdim
Forcat e Armatosura Shqiptare (2001–2004)		26,473	
Projekti i Asgjesimit i NATO-s PFP APM (2001/2002)		2,874	NAMSA
Projekti i Nismës SEE i NATO-s (2003–2004)		1,475	NAMSA
Asgjesimi i financuar nga SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar (2002–2004)		1,229	EOD Solutions Limited
Gjithsej (pa përfshirë projektet në vazhdim)	141,000	32,052	

⁵³⁵ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 21 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 28 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 22 Prill 2005. Shih gjithashtu: 'Ambasadori Italian kritikon Qendrën Anti-trafik në Vlorë', Çështje të Krimit dhe Korrupsionit në Shqipëri, 5–11 Mars 2005. Burimi: Shekulli, 9 Mars 2005.

⁵³⁶ Asistencë ndërkombëtare për asgjesimin e armatimeve përshkruhet në paragrafin 6.1.3.

⁵³⁷ 'Memorandumi i Asgjesimit të Armeve të Vogla dhe të Lehta në Shqipëri', Zyra e Çështjeve Publike, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, <www.state.gov>. Shiko gjithashtu website e EOD Solutions Ltd. <http://www.eod-solutions.com>.

EOD Solutions Ltd iu kërkua të asgjesonte një shumëllojshmëri AVL-sh, që nga pistoletat dhe pushkët luftarake deri te pushkët zbrapëse, automatike të kalibrit të rëndë dhe granatë-hedhëset e raketave eksploziv.⁵³⁸ Përveç dy ekspertëve teknikë Britanikë të EOD Solutions Ltd, nëntë Shqiptarë u punësuan dhe u trajnuan për çmilitarizimin e AVL-ve të tepërta, për të plotësuar elementin e ndërtimit të kapacitetit lokal të parashikuar në kontratë. Metoda e preferuar për çmilitarizimin e AVAL ishte prerja e tytës së armëve, e aksesorëve dhe/ose mekanizmit të shkrehjes. Nëse kishte ndonjë bajonetë që futej tek AVL-të, edhe ajo do të pritej. Kjo kontratë përfshiu gjithashtu zhvillimin e mëtejshëm të qendrës çmilitarizuese në bazën ushtarake Mengel afër Elbasanit.

Në vitin 2004 FASH dhe EOD Solutions ndërmorën një projekt tjetër për të asgjesuar së pari 12,500 AVL, me financim të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar përmes ambasadës së saj në Tiranë, dhe më pas 12,500 të tjera me financim nga Qeveria e SHBA.⁵³⁹ Të njëjtat metoda dhe i njëjti personel i punësuar në projektet e vitit 2001 u përdorën përsëri, megjithëse në paketë u përfshinë trajnime freskuese. Përsëri llojet e AVL-ve të asgjesuara varionin nga pistoletat deri në mitralozë të rëndë. Sidoqoftë, një numër armësh që duhej të të asgjesoheshin, në fakt u ruajtën nga procesi i prerjes për shkak të vlerës së tyre historike. Sipas EOD Solutions Ltd, për shkak të gjetjes së një numri të konsiderueshëm të armëve me vlera historike mes atyre të destinuara për asgjësim, u ngrit një komision i veçantë për të vlerësuar armët e ruajtura që do të ekspozoheshin në muzeun ushtarak shqiptar.⁵⁴⁰

Gjithsesi, zyrtarë të Ambasadës Angleze informuan skuadrën e studimit për shqetësime të dukshme në lidhje me asgjesimin e AVL-ve shqiptare. Në fillim të vitit 2005, Qeveria Shqiptare iu drejtua OSBE-së për financim, për të asgjesuar 10,000 AVL të tepërta.⁵⁴¹ OSBE iu drejtua një numri anëtarësh të saj për financim në këtë fushë, përfshirë dhe SHBA. Sidoqoftë, SHBA nuk po kuptonte se si kishte dalë shifra prej 10,000 AVL, pasi dokumenta të paraqitura më parë OSBE dhe organizatave të tjera nderkombetare nuk tregonin një ekzistence të tillë. Per me teper, kërkesave më të hershme për të asgjesuar AVL-të Ministria Shqiptare e Mbrojtjes iu përgjigj se rezervat e tepërta ishin mbaruar. Akoma edhe në kohën e shkrimit të këtij raporti duket se ka një shkallë konfuzioni në këtë pikë.

Municionet e tepërta gjithashtu përbëjnë një problem të rëndësishëm. Në vitin 2000 Forcat e Armatosura Shqiptare llogaritën se depot e tyre kishin një tepricë prej 117,476 ton municionesh. Në fund të vitit 2004 kjo shifër u reduktua në 85,424 si rezultat i proceseve të asgjesimit të kryera nga FASH, EOD Solutions Ltd, NAMSA dhe Qendra Kombëtare për Çmilitarizim (QKC).⁵⁴² Në vitin 2004 QKC ripaktoi 900 ton municione të pasistemuara për djegie nga ana e NAMSA.⁵⁴³ Organizata kreu gjithashtu shërbime verifikimi dhe kontrolli për NAMSA gjatë asgjesimit të municioneve stoqe të Ministrisë së Mbrojtjes. Gjithashtu u punua për përmirësimin e kapacitetit të Ministrisë së Mbrojtjes për të vepruar me armatimet e tepërta. Në vitin 2003 SHBA financoi EOD Solutions të jepte asistencë teknike për ekspertët e municionit brenda Ministrisë Shqiptare të Mbrojtjes. NATO gjithashtu siguroi 2,5 milionë dollarë për instalimin e një furre djegieje në qendrën e asgjesimit të armëve në Elbasan, që pas disa vonesave të fillimit, pritet të fillojë të veprojë në fund të 2005.⁵⁴⁴

Në vitin 2004 Ministria e Mbrojtjes zhvilloi një strategji për shkatërrimin e tepricave të municioneve që specifikon prioritetet e asgjesimit, metodat dhe kostot, dhe

⁵³⁸ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 23 Korrik 2005; Shiko gjithashtu website e EOD Solutions Ltd. <<http://www.eod-solutions.com>>.

⁵³⁹ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 29 Prill 2005; zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 17 Mars 2005; zyrtar ndërkombëtar, 19 Prill 2005.

⁵⁴⁰ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 23 Korrik 2005; Shiko gjithashtu website e EOD Solutions Ltd. <<http://www.eod-solutions.com>>.

⁵⁴¹ Intervistë me zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 17 Mars 2005.

⁵⁴² Sipas statistikave të dhëna nga Ministria Shqiptare e Mbrojtjes, në periudhën 2001 – 2004, FASH asgjesuan 26,473 ton armatime (11,404 në 2004), NAMSA asgjesoi 2874 ton mina anti-njeri dhe 1,475 ton armatim (1,440 në 2004) dhe EOD Solutions Ltd asgjesoi 1,229 ton armatim (330 në 2004).

⁵⁴³ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 18 Mars 2005.

⁵⁴⁴ Ibid.

identifikon depo të veçanta për asgjesim. Megjithëse strategjia po pret miratimin zyrtar dhe nuk është financiar plotësisht, ajo është përdorur gjithsesi për të drejtuar punën në këtë fushë.⁵⁴⁵ Asgjesimi i municionit gjithsesi, po bëhet edhe më i vështirë pasi me shumë prej artikujve më të lehtë e më të lirë tashmë është vepruar, duke lënë nëpër depo armatime teknikisht më të rënda (p.sh artileri të mesme dhe mortaja). Me rritjen e kostos për artikull, po pakësohet gjithashtu interesi i donatorëve për asgjesimin e AVL.⁵⁴⁶ Në të njëjtën kohë, pajisje të tjera ushtarake janë konsideruar një prioritet më i madh për asgjesim. Për shëmbull, SHBA tani po vë theksin mbi programe asgjesimi të armëve bërthamore, minave dhe silurave detarë.

Sfidat e hasura nga ushtria Shqiptare për magazinimin e sigurt të AVL-ve dhe municioneve të saj aktive dhe të tepërta janë ilustruar diku tjetër në këtë raport (shiko paragrafin 5.1.1.2). Gjatë viteve të fundit ka pasur asistencë ndërkombëtare për të mbështetur menaxhimin e rezervave dhe programet e sigurimit në Shqipëri. Sidoqoftë kjo mbështetje nuk ka qenë në përpjestim të drejtë si me përmasat ashtu dhe me shkallën e problemit, për shkak të menaxhimit të dobët të rezervave prej kohësh e shoqëruar kjo dhe nga nevoja shtesë të magazinimit si rrjedhim i pakësimit të vazhdueshëm të forcave ushtarake. Ushtria Shqiptare ka marrë asistencë nga komuniteti ndërkombëtar për përshtatjen e sistemit të saj të ruajtjes e magazinimit me standarteve e NATO-s. Kontraktuesi Anglez EOD Solutions e këshilloi Ministrinë e Mbrojtjes në procesin e heqjes së sistemit të vjetër dhe afrimin e saj tek strukturat bazë të NATO-s për planifikimin e menaxhimit të municionit. Kjo u arrit duke përdorur udhëzimet e përdorura nga NATO mbi magazinimin e municionit, e kombinuar kjo me sistemin aktual Shqiptar, si një hap i rëndësishëm drejt integritetit të plotë në NATO. Kompania gjithashtu ‘autorizoi’ gjashtë qendra magazinimi sipas udhëzimeve të NATO-s dhe Mbretërisë së Bashkuar me qëllim që të asistonte Ministrinë Shqiptare të Mbrojtjes në planifikimin e ardhshëm të magazinimit të municionit. Këto qendra gjithsesi, nuk do të përputhen plotësisht me standartet e NATO-s dhe Mbretërisë së Bashkuar derisa municionet shtesë të prapambetura të reduktohen dhe derisa të vihet në dispozicion më shumë hapësirë. Forcat e Armatosura Shqiptare kanë përfituar edhe mbështetje dypalëshe në këtë fushë. Gjatë vitit 2004 SHBA financoi një projekt për të rritur sigurinë e rezervave të MANPAD dhe tani tre gardhë rrethojnë qendrën magazinuese në fjalë ku nevojiten 5 çelësa për të hyrë në objekt.⁵⁴⁷ Ndërkohë që ekziston dëshira e mirë dhe angazhimi për të përmirësuar praktikën, duket qartë se kërkohet akoma më shumë mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar.

Tabela 30: Asistencë ndërkombëtare për rritjen e menaxhimit dhe sigurimit të magazinimit të armatimeve dhe AVAL

Projekti	Zbatuesi	Donatori
Shqipëria		
Magazinim i sigurt (eksplozivë, municione AV) Maj 2002	Shtabi i NATO	NATO
Magazinim i sigurt (eksplozivë, municione AV) në vazhdim	EOD Solutions Ltd	SHBA

5.2.2 Asistencë ndërkombëtare: menaxhimi i kufijve dhe anti-trafikimi

Në fillim të 2002, u lançua një nismë për të përmirësuar bashkërendimin e asistencës së donatorëve ndërkombëtarë për Shqipërinë në fusha që kanë lidhje me menaxhimin e kufijve dhe të trafikimit. U krijua një ‘Konsorcium Ndërkombëtar’ i donatorëve të huaj më kryesorë dhe agjensive partnere shqiptare, i cili mblidhet rregullisht për të informuar partnerët për projektet aktuale dhe të planifikuara, për të parë mundësi për kombinim fondesh dhe shmangien e duplikimeve të projekteve dhe sigurimin e

⁵⁴⁵ Ibid; intervistë me zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 17 Mars 2005.

⁵⁴⁶ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 18 Mars 2005.

⁵⁴⁷ Intervistë, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 17 Mars 2005.

trajnitimit.⁵⁴⁸ Në vitin 2004, një numër i madh donacionesh, programesh dhe projektesh trajnimi u ndërmorën nga partnerët ndërkombëtarë me Ministrinë e atëhershme të Rendit Publik që përfshiu një asistencë ndërkombëtare prej €4,117,921.

Tabela 31: Shumat e asistencës ndërkombëtare për Ministrinë e Rendit Publik në 2004⁵⁴⁹

Donatoriri	Shuma (€)
Misioni ICITAP	1,300,000 (US\$1,620,000)
Projekti PHARE i BE	1,455,764
Programi CARDS i BE	550,000
OSBE	120,000
Qeveria Italiane	570,000
Interpoli Francez	72,157
Qeveria Gjermane	50,000
Total	4,117,921

Aktivitetet e treguara më poshtë u ndërmorën gjatë vitit 2004 në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe Migracionit. Ato tregojnë një numër palësh të interesuara dhe radhën e aktiviteteve të tyre.⁵⁵⁰

- IOM dhe Akademia Shqiptare e Policisë trajnuan 175 staf të gradës së mesme të Policisë Kufitare dhe Migracionit për çështjet e anti-trafikut;
- Dy kurse trajnimi u kryen me Interforze për pëdorimin e radarit;
- Delegacioni i BE në Shqipëri siguroi një sërë pajisjesh inspektimi për pikat e kalimit kufitar;
- Zyra e OSBE-së në Shqipëri dhuroi një rrjet radio-komunikimi dhe pajisje shtesë për Policinë Kufitare (vlera e përlllog. €120,000).

5.1.9.1 ICITAP

ICITAP filloi punën në Shqipëri në vitin 1998 dhe në vitin 2000 programi filloi të vepronte nga një bazë në Shqipëri. Ka përdorur rreth 8 milionë USD për projekte të ndryshme me theksin mbi masat kundër trafikut dhe sigurisë së kufijve.⁵⁵¹ Projektet kryesore deri tani janë:

- ‘Strategjia e Tri Portave’ (shih më poshte)
- SMIT (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Total)
- Asistencë teknike mbi strategjitë e anti-trafikut dhe krimit të organizuar

‘Strategjia e Tri Portave’ është krijuar në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të konsorciumit ndërkombëtar. ICITAP këshillon mbi mënyrat e përmirësimit të masave të sigurisë dhe anti-trafikut në aeroportin e Rinasit dhe në portet detare të Durrësit dhe Vlorës. Theksi më i madh u vu në sigurimin e pajisjeve dhe trajnimit të personelit, përfshi dhe stervitjet e qenve për zbulimin e drogës dhe eksploziveve. Me privatizimin e aeroportit të Rinasit dhe me programin për asistencë të Bankës Botërore për të mundësuar trafikun e kontenerëve përmes portit të Durrësit, nevojat për siguri në portet e Shqipërisë po ndryshojnë dhe çdo sigurim në çdo port do të nevojitet të shtohet për të plotësuar kërkesa të reja në këtë fushë. Vonesa të dukshme në kryerjen e disa nga projektet që përbëjnë këtë Strategji duket të jenë të jenë shkaktuar të paktën pjesërisht për shkak të mungesës së prioriteteve të dhëna për zbatim nga zyrtarët qeveritarë.

⁵⁴⁸ Partnerët në konsorciumin ndërkombëtar përfshijnë: Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Ministrinë Shqiptare të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministrinë Shqiptare të Rendit Publik, Policinë e Shtetit Shqiptar, CAM-A, Këshillin e Evropës, Ambasada e Francës, Ambasada e Gjermanisë, Ambasada e Greqisë, Ambasada e Italisë, Ambasada e Turqisë, Ambasada Britanike, Ambasada e SHBA, ICITAP, QNZHPM, Interforze, IOM, OPDAT, Zyra e OSBE-së në Shqipëri, PAMECA, Save the Children, UNDP, KLBKR, ZKBKDO.

⁵⁴⁹ Op cit MOPO, p. 93.

⁵⁵⁰ Ibid, pp. 77–8.

⁵⁵¹ Op cit Bumçi, Ymeri and Dakli, p. 32.

SMIT është një sistem i kompjuterizuar të dhënash që përbëhet nga katër elementë:

- Sistem informacioni për kontrollin e kufijve – p.sh mbajtja e të dhënave për kalimin e kufijve
- Menaxhimi i rasteve
- Inteligjenca Kriminale
- Database Kriminale

SMIT është instaluar në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe në një numër stacionesh policie – gjithsej në 64 vende në të gjithë Shqipërinë. Projekti është bashkëfinancuar nga programi CARDS i BE dhe ICITAP ka siguruar deri tani 1,500,000 USD për instalimin e pajisjeve të nevojshme. Shpresohet që sapo SMIT të jetë plotësisht funksional, ai do ulë konsiderueshëm mundësitë për korrupsion dhe do t'u japë mundësi autoriteteve qëndrore të analizojnë të dhënat mbi trafikimin dhe krimin e organizuar shumë më shpejt dhe në mënyrë eficiente sesa aktualisht.

Për më tepër, ICITAP ka një këshilltar në zyrën e Kryeministrit, i ngarkuar me detyrën për të asistuar Shqipërinë të zbatojë strategjinë e saj anti-trafik dhe një këshilltar në zyrën e krimit të organizuar. I pari është i ngarkuar me detyrën për të përmirësuar bashkërendimin e përpjekjeve për të ndaluar trafikun, krimin e organizuar, korrupsionin dhe çështje të tjera të kësaj fushë. Këshilltari i dytë ka punuar me Task Forcën për krimin e organizuar për përmirësimin e masave kundër krimit të organizuar dhe trafikimit në zonat prioritare të Durrësit, Fierit, Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës.

5.1.9.2 Bashkimi Evropian

Në të shkuarën e afërt, BE duket se ka dhënë prioritarizuar financimin të çështjeve të lidhura me Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme në Shqipëri, me misionet për përmirësimin e kapaciteteve të doganave (CAM) dhe policisë PAMECA duke siguruar programe të ndryshme trajnimi dhe pajisje për agjencitë shqiptare të sigurimit të kufijve dhe zbatimit të ligjit, të konsideruara për të përfutur një pjesë të madhe të BE-së në Shqipëri.⁵⁵² Programi CARDS i BE për Shqipërinë për periudhën 2001–6 është përqëndruar në të mëposhtmet:

- CARDS 2001: €1.5 milion të shpenzuar në projekte të hartuar për të përmirësuar pajisjet, trajnimin dhe pajisjet e inspektimit të policisë kufitare nëpërmjet projekteve të binjakëzimit; përveç kësaj, një projekt u kërkua për përcaktimin e kufijve blu të Shqipërisë;
- CARDS 2002: €400,000 për pajisje të inspektimit të automjeteve për pikat e kalimit kufitar;
- CARDS 2003: €1 milion për pajisje të kontrollit të dokumenteve për policinë e kufirit, për të gjitha pikat e kalimit kufitar që kërkuan të tilla pajisje, pajisje vëzhgimi, automjete, pajisje lëvizëse për pikat e kalimit kufitar; €4 milion për ndërtimin dhe sigurimin e një pike të përbashkët kufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi (pajisjet do të dorëzohen në vjeshtën e 2005).⁵⁵³

Në vitin 2005, do të fillojë faza zbatuese e programit CARDS 2002 program i cili do të përqendrohet në:⁵⁵⁴

- Krijimin e një rrjeti transmetuesh i të dhënave (projekti i ndërmarrë nga SMIT);
- Rinovimin e pjesshëm të 47 komisariateve dhe pikave të kalimit kufitar;
- Rinovimin e hotel Arbana për ta përdorur si Selinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Zbatimin e Strategjisë së Kufijve Kombëtarë.

⁵⁵² Op cit Bumçi, Ymeri dhe Dakli, f. 13.

⁵⁵³ Intervista, zyrtar nderkombetar, 28 Prill 2005; zyrtar nderkombetar 28 Prill 2005.

⁵⁵⁴ Op cit Ministria e Rendit Publik, f. 49.

Aktualisht janë dy misione të Komisionit Evropian në Shqipëri që përqendrohen në përmirësimin e kapaciteteve organizuese dhe vepruese të organizmave hqiptarë të sigurimit të kufijve dhe zbatimit të ligjit. Këto misione janë:

- CAM-A (Misioni i Asistencës Doganore – Shqipëri)
- PAMECA (Misioni i Asistencës Policore i Komisionit Evropian në Shqipëri)

CAM-A

CAM-A u krijua në vitin 1997 pas një kërkesë të Qeverisë Shqiptare bërë Komunitetit Evropian me riorganizimin e drejtorive të saj të doganave. Që atëherë, CAM-A ka punuar me një sërë projektesh me shërbimet doganore shqiptare, përfshi:

- Përmirësimin e legjislacionit doganor dhe zbatimin e tij, me synim arritjen e standarteve të BE-së dhe Organizatës Botërore të Tregëtisë ;
- Krijimin e skuadrave anti-kontrabandë;
- Instalimin dhe trajnimin për përdorimin e programit doganor ASYCUDA++;
- Përfshirjen e stafit të CAM-A përkrah stafit shqiptar në pikat doganore;
- Inisiativën e Krimit të Organizuar (IKO).⁵⁵⁵

Ajo ka ndihmuar së fundmi edhe në instalimin dhe trajnimin për pajisjet e kontrollit të pasaportave, e financuar nga BE, dhe me ICITAP, EXPAS (SHBA), Ambasadën Britanike dhe agjentët doganorë Suedezë për përmirësimin e shkëmbimit të informacionit dhe sigurisë së kufijve.

CAM-A vepron si një zyrë qendrore për organizmat ndërkombëtarë dhe donatorët në lidhje me mbështetjen e kërkesave të Shqipërisë në rritjen e shërbimeve doganore me qëllim shmangien e dublikimit të donacioneve dhe programeve trajnuese.

Anëtarë të skuadrës IKO të CAM-A punojnë me kolegët shqiptarë në pikat e kalimit kufitar në të gjithë Shqipërinë. Fakti që stafi kufitar dhe doganor i CAM-A punon 'në terren' me kolegë shqiptarë, duke kryer kontrole fizike me shqiptarët në çdo lloj kohe, ka ndihmuar në fitimin e respektit dhe besimit të një pjese të mirë të personelit shqiptar të kufirit dhe të doganës. Skuadrat e IKO të CAM-A kanë punuar në kufijtë me Greqinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, në portet e Durrësit dhe Vlorës si dhe aeroportin e Rinasit. Këto skuadra i kanë kaluar dy vitet e fundit duke treguar praktikën me të mire në inspektimin e automjeteve, kalimin e njerëzve, kontrollin e dërgesave dhe duke lehtësimin bashkëpunimin mes agjencive përmes trajnimeve të përbashkëta dhe praktikave të përditshme me rojet kufitare dhe doganore.

Sipas një anëtari madhor të skuadrës së CAM-A, një prej qëllimeve të tyre kryesore është të ndihmojnë rojet kufitare dhe doganore të punojnë së bashku në nivele të ndryshme. Prandaj, CAM-A mori inisiativën e krijimit të një mekanizmi për takimet e PKD (Pikat e Kalimit Doganor) që të bëheshin në pikat e kalimit kufitar të paktën një herë në muaj dhe në pika të tjera çdo javë. Në këto situata, vendet e takimit janë alternuar mes dy anëve, me rojet respektive kufitare dhe doganore në secilin vend duke shkëmbyer informacion dhe zbulime mbi krimin e organizuar dhe çështjet e trafikut.

PAMECA

PAMECA filloi të veprojë në Shqipëri në Dhjetor 2002, nën programin CARDS 2001. Raporti i saj fillestar ishte planifikuar për 2002–4, por u shty për periudhën 2005–7.⁵⁵⁶ Për programin e punës 2005–2007, €10.8 milion u caktuan për financimin e trajnimeve, seminareve, mbledhjeve të punës, përgatitjen e studimeve dhe strategjive, kompjuterizimin e Ministrisë së Brendshme (MB) dhe policisë, dhe sigurimin e pajisjeve të tjera që nga ato telekomunikuese deri tek aparatet zbuluese.⁵⁵⁷

⁵⁵⁵ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 27 Prill 2005.

⁵⁵⁶ PAMECA vazhdon disa prej detyrave të dhëna nga Njësia Shumëkombëshe Këshilluese e Policisë (NJSHKP) që u drejtua nga Bashkimi Evropian Perendimor, dhe ishte vendosur në Shqipëri nga Maj 1997 deri në Qershor 2001. Në Shtator 2001, KE bëri një bashkëfinancim me projektin PHARE dhe MAPKE dhe që u drejtua, deri sa u krijua, PAMECA. Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 21 Prill 2005. Shiko gjithashtu: PAMECA, Propozimi i Programit të Punës 2005, f. 8.

⁵⁵⁷ Op cit PAMECA, pp. 28–44.

Objektivat e PAMECA përfshijnë:

- Asistencën për MB për të zhvilluar një 'strategji qeveritare gjithëpërfshirëse e afatgjatë';
- Përmirësimin e 'kapaciteteve për përgjigje dhe hetim' të policisë së shtetit shqiptar për rendin dhe sigurinë, menaxhimin e kufijve, krimin e organizuar dhe terrorizmin;
- Rritjen e niveleve të profesionalizmit, efektivitetit, kapaciteteve organizative;
- Fuqizimin e bashkëpunimit me elementë të tjerë në sistemin e drejtësisë e krimit;
- Zhvillimin e kapaciteteve për shkëmbim informacioni;
- Rritjen e përdorimit eficient të fondeve të donatorëve;
- Rivendosjen e besimit të publikut tk policia.⁵⁵⁸

Megjithëse PAMECA e ka bazën në Tiranë, zyrtarët e saj theksuan se ndërmarrin aktivitete të shpërndara në të gjithë Shqipërinë, me programe trajnuese nëpër terrene në zona të ndryshme të vendit, përfshi: mbështetjen e policisë kufitare për zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Kufijve Shqiptarë të Integruar dhe metoda vepruese për luftimin e krimit të organizuar.⁵⁵⁹ Njësoj si ICITAP, edhe PAMECA ka këshilltarët e saj në zyrat e Ministrisë së Rendit Publik dhe në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.⁵⁶⁰

Një shëmbull i punës së kryer nga zyrtarët e PAMECA është një projekt 12 mujor binjakëzimi i fokusuar në trajnimet për lidhshp dhe menaxhim me shefat e të gjithë komisariteve, që po udhëhiqet aktualisht nga grekët.⁵⁶¹ Janë planifikuar seanca të përbashkëta trajnimi për policinë kufitare dhe doganat mbi çështjet e menaxhimit të integruar të kufijve. Projekti përfshin gjithashtu trajnim të elementëve të trajnuesve për të mbështetur hapjen ndaj të tjerëve. Është parashikuar se elementi i fundit i projektit do të ndihmojë në trajnimin e rreth 2/3 së oficerëve të policisë për menaxhimin e integruar bazë të kufijve. Pritet që ky projekt të asistojë me metoda zbulimi të dokumentave të ndryshuar, trajnim për pajisje në 8 pika kryesore të kalimit të kufirit, botimin e një manuali për zyrtarët e lartë të policisë kufitare, një manual për stafin bazë lokal, dhe të sigurojë materiale për kurrikulumin trajnues të policisë kufitare, të cilës i mungojnë aktualisht programet trajnuese për oficerët e policisë kufitare.

⁵⁵⁸ Ibid, p. 9.

⁵⁵⁹ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 21 Prill 2005.

⁵⁶⁰ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 21 Prill 2005.

⁵⁶¹ Ky projekt është financuar nga CARDS 2001.